# СЛУЖБЕН ВЕСНИК

## на Република Северна Македонија

**Број 267** **9 ноември 2020, понеделник** **година LXXVI**

**www.slvesnik.com.mk** **contact@slvesnik.com.mk**


**СОДРЖИНА**


| | | Стр. |
|---|---|---|
| 3512. | **Закон** за изменување и дополнување на Законот за данокот на додадена вредност.................................... | **2** |
| 3513. | **Закон** за изменување на Законот за пензиското и инвалидското осигурување................................................ | **5** |
| 3514. | **Закон** за изменување на Законот за работните односи.............................. | **5** |
| 3515. | **Закон** за финансиска поддршка на физички лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, за месеците октомври, ноември и декември 2020 година........................... | **12** |
| 3516. | **Закон** за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците октомври, ноември и декември 2020 година........................................ | **16** |
| 3517. | **Правилник** за престанување на важењето на Правилникот за проверка на способностите и оценка на личните предиспозиции на лицата за вршење на работите на финансиската полиција............................... | **23** |
| 3518. | **Правилник** за престанување на важењето на Правилникот за критериумите на прибирање на информации и податоци и критериумите на посредните методи за докажување на приходите.................................... | **23** |
| 3519. | **Правилник** за престанување на важењето на Правилникот за мерките за обезбедување на деловни простории регистрирани за вршење на дејност, магацини и други објекти за складирање на стока, предмети и документација за деловно работење....... | **23** |
| 3520. | **Правилник** за престанување на важењето на Правилникот за службената униформа на финансиската полиција................................................. | **24** |
| | **Огласен дел**..................................... | **1-8** |

# СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

**3512.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

## У К А З
## ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ДАНОКОТ НА ДОДАДЕНА ВРЕДНОСТ

Се прогласува Законот за изменување и дополнување на Законот за данокот на додадена вредност,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 6 ноември 2020 година.

Бр. 08-3923/1
6 ноември 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
**Стево Пендаровски,** с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi,** с.р.

## З А К О Н
## ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ И ДОПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ДАНОКОТ НА ДОДАДЕНА ВРЕДНОСТ

Член 1

Во Законот за данокот на додадена вредност („Службен весник на Република Македонија“ број 44/1999, 86/1999, 8/2001, 21/2003, 19/2004, 33/2006, 101/2006, 114/2007, 103/2008, 114/2009, 133/2009, 95/10, 102/10, 24/11, 135/11, 155/12, 12/14, 112/14, 130/14, 15/15, 129/15, 225/15, 23/16, 189/16 и 198/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 98/19, 124/19 и 275/19), по членот 24-а се додаваат два нови члена 24-б и 24-в, кои гласат:

„Член 24-б

(1) Се ослободува од данок на додадена вредност, прометот на добра и услуги кои како донација се дадени на буџетски корисник за справување со коронавирусот COVID-19.

(2) За стекнување на правото на ослободување од данокот на додадена вредност, давателот на донацијата треба да обезбеди потврда од страна на буџетскиот корисник за примената донација пропишана согласно со Правилникот за формата, содржината и начинот на издавање на писмена потврда за донации во јавните дејности.

(3) Потврдата од ставот (2) на овој член може да биде разменета меѓу давателот на донацијата и примателот на донацијата во електронска форма и по електронски пат (pdf и сл. формат, кој може да се отпечати) или во хартиена форма.

(4) Давателот на донацијата води евиденција за дадената донација по прималел на донација, број на потврда за примена донација, договор за донација, краток опис на донацијата и вредност на дадената донација во добра и услуги.

(5) За прометот на добра и услуги кои како донација се дадени на буџетски корисник коишто се ослободени согласно со ставот (1) на овој член, вршителот на промет во фактурата го наведува основот за ослободувањето од данокот на додадена вредност.

Член 24-в

(1) Се ослободува од данок на додадена вредност, прометот на добра и услуги извршен кон буџетски корисник заради справување со коронавирусот COVID-19 кој се плаќа со финансиски средства од примени донации на буџетски корисник.

(2) За ослободувањето од данокот на додадена вредност на прометот од ставот (1) на овој член, вршителот на промет треба да обезбеди изјава од буџетскиот корисник во која изјавува под целосна кривична и материјална одговорност дека прометот се плаќа со донирани финансиски средства.

(3) Вршителот на прометот од ставот (2) на овој член води евиденција за прометот на добра и услуги кон буџетскиот корисник од ставот (1) на овој член.

(4) За прометот на добра и услуги извршен кон буџетски корисник кој се плаќа со финансиски средства од примени донации на буџетски корисник коишто се ослободени согласно со ставот (1) на овој член вршителот на промет во фактурата го наведува основот за ослободувањето од данокот на додадена вредност.“.

Член 2

Во член 28 во точката 2. на крајот од реченицата точката се брише и се додаваат зборовите: „и од 10%.“.

Член 3

Во член 30 став (2) во точката 3. сврзникот „и“ на крајот од реченицата се заменува со точка и запирка.

Во точката 4, точката на крајот од реченицата се заменува со сврзникот „и“, и се додава нова точка 5. која гласи:

„5. Занаетчиски услуги коишто се вршат од страна на занаетчии коишто се запишани во занаетчиски регистар согласно со Законот за занаетчиство, и тоа:

(а) Поправка на:

- велосипеди,
- чевли и производи од кожа,
- облека и постелнина за домаќинството (вклучувајќи крпење и прекројување) и

(б) фризерски услуги.“.

Член 4

По членот 30 се додава нов член 30-а кој гласи:

„Член 30-а

(1) Повластената даночна стапка од 10% се применува на услуги на предавање на храна и на пијалаци за консумација на лице место и кетеринг услуги, со исклучок на алкохолни пијалаци.

(2) Владата на Република Северна Македонија поблиску ги определува услугите со повластена даночна стапка од 10% на данокот на додадена вредност од ставот (1) на овој член.“.

Член 5

Во член 41-б по ставот (1) се додава нов став (2), кој гласи:

„(2) Даночниот обврзник примател на прометот на добра и услуги за кој е даночен должник согласно со членот 32-а од овој закон, има обврска да изготви извештај за примени промети од членот 32-а од овој закон.“.

Ставот (2) кој станува став (3), се менува и гласи:

„(3) Даночниот обврзник го доставува извештајот од ставот (1) на овој член, заедно со даночната пријава, до надлежниот даночен орган за прометите извршени во периодот за кој се однесува даночната пријава, а извештајот од ставот (2) на овој член го доставува заедно со даночната пријава, до надлежниот даночен орган за примени промети во периодот за кој се однесува даночната пријава.“.

Ставот (3) кој станува став (4) се менува и гласи:

„(4) Министерот за финансии ги пропишува формата и содржината на извештаите од ставовите (1) и (2) на овој член.“.

Член 6

Во член 43 ставот (2) се менува и гласи:

„Данокот пресметан и пријавен за соодветниот даночен период, даночниот обврзник го плаќа најдоцна во рок од пет дена по истекот на роковите пропишани во членот 41 ставови (1) и (4) од овој закон, во кои се поднесува даночната пријава.“.

Член 7

Во член 45 ставот (1) се менува и гласи:

„Ако износот на претходниот данок во одреден даночен период е поголем од износот на данокот кој е пресметан за прометот кој го извршил, како и за прометот за кои тој е даночен должник според членот 32-а од овој закон, разликата му се враќа на даночниот обврзник врз основа на негово барање кое го искажува во даночната пријава. Бараната разлика нема да се врати на даночниот обврзник доколку  во даночната пријава е искажано барање за отстапување на разликата на данокот за намирување на даночни обврски на друг даночен обврзник, а доколку бараната разлика е поголема од износот кој се користи за намирување на даночните обврски на друг даночен обврзник, тогаш остатокот ќе се врати на даночниот обврзник. Барањето за отстапување на разликата на данок може да се искаже во даночната пријава само доколку даночниот обврзник нема долгови по други јавни давачки. Доколку даночниот обврзник не искаже барање за враќање или барање за отстапување на разликата искажана во даночната пријава, таквата разлика се пренесува како даночна аконтација за следниот даночен период.“.

Член 8

По членот 53-б се додава нов член 53-в, кој гласи:

„Член 53-в

(1) За фактура во електронска форма покрај фактурите издадени согласно со членот 53-б од овој закон се сметаат и фактура во електронска форма (pdf или друг електронски формат) која ги содржи сите елементи согласно со членот 53 став (10) од овој закон и е доставена по електронски пат до примателот на прометот.

(2) Вршителот на промет, кој ја издава фактурата од ставот (1) на овој член е должен да го извести примателот на прометот, преку електронска пошта, електронска порака и/или на друг начин дека фактурите и другите документи од членот 53 став (2) од овој закон ќе ги издава во формата од ставот (1) на овој член.

(3) Вршителот на прометот кој нема да го извести примателот на прометот согласно со ставот (2) на овој член ќе продолжи да издава фактури и други документи од членот 53 став (2) од овој закон во хартиена форма.

(4) Примателот на прометот во рок од 10 дена од приемот на известувањето од ставот (2) на овој член има право да го извести издавачот на фактурата дека ја одбива формата на достава од ставот (1) на овој член. Доколку по истекот на 10 дена од примeното известување од ставот (2) на овој член, примателот на прометот не ја одбие формата на достава, ќе се смета дека е согласен доставата на фактури да се врши на начин утврден согласно со ставот (1) на овој член.

(5) Фактурите од ставот (1) на овој член на примателот на фактурата му даваат право на одбивка на претходниот данок согласно со овој закон.

(6) Фактурата во електронска форма од ставот (1) на овој член мора да ги исполнува барањата утврдени во член 53-б став (3) од овој закон.

Член 9

Одредбите на членот 1 со кои се додаваат членовите 24-б и 24-в, член 6 со кои во членот 43 се менува ставот (2) и член 8 со кои се додава нов член 53-в од овој закон ќе се применуваат до 31 декември 2021 година.

Член 10

Одредбите на членот 2 со кои се дополнува член 28 точка 2, членот 3 со кои се дополнува членот 30 ставот (2) со нова точка 5, членот 4 со кои се додава нов член 30-а, членот 5 со кои се дополнува членот 41-б со нов став (2) и се менуваат ставовите (3) и (4) и членот 7 со кои се менува член 45 ставот (1) од овој закон ќе започнат да се применуваат од 1 јануари 2021 година.

Член 11

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

---

**L I GJ**
**I NDRYSHIMIT DHE I PLOTËSIMIT TË LIGJIT TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR**

Neni 1

Në Ligjin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër  44/99, 86/99, 8/01, 21/03, 19/04, 33/06, 101/06, 114/07, 103/08, 114/09, 133/09, 95/10, 102/10, 24/11, 135/11, 155/12, 12/14, 112/14, 130/14, 15/15, 129/15, 225/15, 23/16, 189/16, 198/18, dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër  98/19, 124/19 dhe 275/19) pas nenit 24-a shtohen dy nene të reja 24-b dhe 24-v, siç vijojn:

“Neni 24-b

(1) Lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve që si donacion u janë dhënë shfrytëzuesve buxhetorë për t'u përballur me virusin korona COVID – 19.

(2) Për të fituar të drejtën e lirimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar, dhënësi i donacionit duhet të sigurojë vërtetim nga përdoruesi i buxhetit për donacionin e marrë të përshkruar në përputhje me Rregulloren e Formës, të Përmbajtjes dhe të Mënyrës së Lëshimit të Vërtetimit me Shkrim të Donacioneve në Veprimtaritë Publike.

(3) Vërtetimi nga paragrafi (2) i këtij neni mund të shkëmbehet ndërmjet dhuruesit të donacionit dhe marrësit të donacionit në formë rrugë elektronike (pdf dhe format të ngjashëm, i cili mund të shtypet) ose në letër.

(4) Dhënësi i donacionit mban evidencë për donacionin e dhënë për marrës të donacionit, numrin e vërtetimit për donacionin e marrë, marrëveshjen për donacion, përshkrimin e shkurtër të donacionit dhe vlerën e donacionit të dhënë në të mira dhe shërbime.

(5) Për qarkullimin e të mirave dhe shërbimeve që si donacion i janë dhënë shfrytëzuesit buxhetor të cilët janë liruar, sipas paragrafit (1) të këtij neni, kryerësi i qarkullimit në faturë e thekson bazën për lirim nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Neni 24-v

(1) Lirohet nga tatimi mbi vlerën e shtuar qarkullimi i të mirave dhe i shërbimeve të kryera ndaj shfrytëzuesit buxhetor për t'u përballur me virusin korona COVID – 19, i cili paguhet me mjete financiare nga donacionet e marra të shfrytëzuesit buxhetor.

(2) Për lirim nga tatimi mbi vlerën e shtuar në qarkullimin nga paragrafi (1) i këtij neni, kryerësi i qarkullimit duhet të sigurojë deklaratë nga përdoruesi i buxhetit në të cilën deklaron me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se qarkullimi paguhet me mjete financiare të dhuruara.

(3) Kryerësi i qarkullimit nga paragrafi (2) i këtij neni mban evidencë për qarkullimin e të mirave dhe shërbimeve ndaj shfrytëzuesit buxhetor nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Për qarkullimin e të mirave dhe të shërbimeve të kryera ndaj shfrytëzuesit buxhetor të cilat paguhen me mjete financiare nga donacionet e marra të shfrytëzuesit buxhetor që janë liruar, sipas paragrafit (1) të këtij neni, kryerësi i qarkullimit në faturë e thekson bazën për lirimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar.”

Neni 2

Në nenin 28 pika 2, në fund të fjalisë, pika fshihet dhe shtohen fjalët: “dhe nga 10%.”

Neni 3

Në nenin 30 paragrafi (2) pika 3, lidhëza “dhe” në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 4, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën “dhe”, dhe shtohet pikë e re 5., siç vijon:

„5. Shërbimet zejtare të kryera nga ana e zejtarëve të cilët janë regjistruar në regjistrin e zejtarëve në përputhje me Ligjin e Zejtarisë, edhe atë:

(a) Rregullim i:

- biçikletave,
- këpucëve dhe prodhimeve të lëkurës,
- veshmbathjeve dhe shtrojave për amvisëri (duke përfshirë arnimin dhe riprerjen) dhe

(b) shërbime parukerie.”.

Neni 4

Pas nenit 30 shtohet nen i ri 30-a, siç vijon:

“Neni 30-a

(1) Shkalla e privilegjuar tatimore prej 10% do të zbatohet për shërbimet e dhënies së ushqimit dhe pijeve për konsum aty për aty dhe shërbime hotelerie, me përjashtim të pijeve alkoolike.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut i përcakton saktë shërbimet, me shkallë të privilegjuar tatimore prej 10% të tatimit mbi vlerën e shtuar, nga paragrafi (1) i këtij neni. "

Neni 5

Në nenin 41-b, pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), siç vijon:

„(2) Tatimpaguesi, marrës i qarkullimit të të mirave dhe shërbimeve për të cilin është debitor tatimor, sipas nenit 32-a të këtij ligji, ka për detyrë të përgatisë raport për qarkullimet e marra të nenit 32-a të këtij ligji."

Paragrafi (2), i cili bëhet paragraf (3), ndryshohet dhe bëhet:

„(3) Tatimpaguesi e dërgon raportin e paragrafit (1) të këtij neni, së bashku me fletëparaqitjen tatimore, tek organi kompetent tatimor, për ndryshimet e bëra në periudhën me të cilën ka të bëjë fletëparaqitja tatimore, ndërkaq raportin, sipas paragrafit (2) të këtij neni, e dërgon së bashku me fletëparaqitjen tatimore tek organi kompetent tatimor për qarkullimet e pranuara në periudhën me të cilën ka të bëjë fletëparqitja tatimore.’’

Paragrafi (3), i cili bëhet paragraf (4), ndryshohet dhe bëhet:

„(4) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e raporteve të paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni.”

Neni 6

Në nenin 43, paragrafi (2) ndryshohet dhe bëhet:

"Tatimin e llogaritur dhe të paraqitur për periudhën përkatëse tatimore, tatimpaguesi e paguan më së voni në afat prej pesë ditësh pas përfundimit të afateve të përshkruara, sipas nenit 41 paragrafët (1) dhe (4) të këtij ligji, në të cilat parashtrohet fletëparaqitja tatimore."

Neni 7

Në nenin 45, paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

(1) Nëse shuma e tatimit të mëparshëm në një periudhë të caktuar tatimore është më e madhe se shuma e tatimit që llogaritet për qarkullimin që e ka kryer, si dhe për qarkullimin për të cilin ai është debitor tatimor, sipas nenit 32-a të këtij ligji, diferenca i kthehet tatimpaguesit bazuar në kërkesën e tij të cilën e shpreh në fletëparaqitjen tatimore. Dallimi i kërkuar nuk do t'i kthehet tatimpaguesit, nëse në fletëparaqitjen tatimore është paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga diferenca tatimore për shlyerjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit tjetër, ndërkaq nëse diferenca e kërkuar është më e madhe se shuma e përdorur për shlyerjen e detyrimeve tatimore të tatimpaguesit tjetër, atëherë pjesa e mbetur do t'i kthehet tatimpaguesit. Kërkesa për heqjen dorë nga diferenca tatimore mund të shprehet në fletëparaqitjen tatimore vetëm nëse tatimpaguesi nuk ka borxhe për detyrime të tjera publike. Nëse tatimpaguesi nuk paraqet kërkesë për kthimin ose kërkesë për heqjen dorë nga diferenca e deklaruar në fletëparaqitjen tatimore, dallimi i tillë transferohet si parapagim tatimor për periudhën e ardhshme tatimore."

Neni 8

Pas nenit 53-b shtohet nen i ri 53-v, siç vijon:

„Neni 53-v

(1) Për faturë në formë elektronike, krahas faturave të lëshuara sipas nenit 53-b të këtij ligji, llogariten edhe fatura në formë elektronike (pdf ose format tjetër elektronik) që i përmban të gjitha elementet, sipas nenit 53 paragrafi (10) të këtij ligji, dhe, në formë elektronike, i dërgohet pranuesit të qarkullimit.

(2) Kryerësi i qarkullimit, i cili lëshon faturën nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar të informojë marrësin e qarkullimit, nëpërmjet postës elektronike, mesazhit elektronik dhe / ose në mënyrë tjetër, se faturat dhe dokumentet tjera, sipas nenit 53 paragrafi ( 2) të këtij ligji, do t'i lëshojë në formën sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Kryerësi i qarkullimit i cili nuk e njofton marrësin e qarkullimit, sipas paragrafit (2) të këtij neni, do të vazhdojë të lëshojë fatura dhe dokumente të tjera, sipas nenit 53 paragrafi (2) të këtij ligji, në formë letre.

(4) Marrësi i qarkullimit, në afat prej 10 ditësh nga marrja e njoftimit sipas paragrafit (2) të këtij neni, ka të drejtë ta njoftojë lëshuesin e faturës se e refuzon formën e dërgimit nga paragrafi (1) i këtij neni. Nëse pas kalimit të 10 ditëve nga njoftimi i marrë sipas paragrafit (2) të këtij neni, marrësi i qarkullimit nuk e refuzon formën e dërgimit, do të konsiderohet se pajtohet që dërgimi i faturës të kryhet në mënyrë të përcaktuar sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Faturat e paragrafit (1) të këtij neni i japin marrësit të faturës të drejtën e refuzimit të tatimit paraprak në pajtim me këtë ligj.

(6) Fatura në formë elektronike e paragrafit (1) të këtij neni duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara sipas nenit 53-b paragrafi (3) të këtij ligji.

Neni 9

Dispozitat e nenit 1, me të cilat shtohen nenet 24-b dhe 24-v, të nenit 6, me të cilat te neni 43 ndryshohet paragrafi (2), dhe të nenit 8, me të cilët shtohet nen i ri 53-v i këtij ligji, do të zbatohen deri më 31 dhjetor 2021.

Neni 10

Dispozitat e nenit 2, me të cilat plotësohet neni 28 pika 2, të nenit 3, me të cilat plotësohet neni 30 paragrafi (2) me pikë të re 5, të nenit 4 me të cilin shtohet nen i ri 30-a, të nenit 5, me të cilin plotësohet neni 41-b me paragraf të ri (2) dhe paragrafët (3) dhe (4) ndryshohen, dhe të nenit 7, me të cilin ndryshohet neni 45 paragrafi (1) i këtij ligji, do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2021.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

---

**3513.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**У К А З**
**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ**

Се прогласува Законот за изменување на Законот за пензиското и инвалидското осигурување,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 6 ноември 2020 година.

Бр. 08-3920/1
6 ноември 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
**Стево Пендаровски,** с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi,** с.р.

**З А К О Н**
**ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ПЕНЗИСКОТО И ИНВАЛИДСКОТО ОСИГУРУВАЊЕ**

Член 1

Во Законот за пензиското и инвалидското осигурување („Службен весник на Република Македонија" број 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 и 245/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија" број 180/19, 275/19 и 31/20), во членот 11 став (1) точка 2) зборот „воениот" се заменува со зборовите: „активниот воен".

Член 2

Во членот 76 став 1 точката 3) се менува и гласи:

„3) секои 12 месеци ефективно поминати на тие должности, се сметаат како 15 месеци стаж на осигурување, во вршење на сите останати должности кои ги врши активниот воен и цивилен персонал на служба во Армијата, согласно со Законот за служба во Армијата на Република Северна Македонија, кои не се опфатени во работите и должностите од точките 1) и 2) на овој член.".

Член 3

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија".

---

**L I GJ**
**I NDRYSHIMIT TË LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 180/19, 275/19 dhe 31/20), në nenin 11 paragrafi (1) pika 2), fjala "ushtarak" zëvendësohet me fjalët "ushtarak aktiv".

Neni 2

Në nenin 76 paragrafi 1, pika 3) ndryshohet siç vijon:

"3) çdo 12 muaj të kaluara në mënyrë efektive në ato detyra llogariten si 15 muaj stazh sigurimi, në kryerjen e të gjitha detyrave tjera të cilat i kryen personeli ushtarak dhe civil aktiv i shërbimit të Armatës, në pajtim me Ligjin e Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat nuk janë përfshirë në punët dhe detyrat e pikës 1) dhe 2) të këtij neni."

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

---

**3514.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**У К А З**
**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА РАБОТНИТЕ ОДНОСИ**

Се прогласува Законот за изменување на Законот за работните односи,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 6 ноември 2020 година.

Бр. 08-3919/1
6 ноември 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
**Стево Пендаровски,** с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi,** с.р.

**З А К О Н**
**ЗА ИЗМЕНУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА РАБОТНИТЕ ОДНОСИ**

Член 1

Во Законот за работните односи („Службен весник на Република Македонија“ број 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 и 120/18 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ број 110/19), членот 258 се менува и гласи:

„(1) Ако при вршењето на инспекциски надзор надлежниот инспектор утврди дека субјектот на инспекцискиот надзор сторил прекршок утврден во членовите 265, 265-а и 266 од овој закон, е должен за сторениот прекршок да состави записник, согласно со закон, и со решение на субјектот на инспекцискиот надзор да му изрече инспекциска мерка опомена и да му определи рок во кој е должен да ги отстрани утврдените неправилности и недостатоци.

(2) Решението од ставот (1) на овој член, се донесува веднаш, а најдоцна во рок од осум дена од денот на изготвувањето на записникот, согласно со закон.

(3) Кога при вршењето на инспекцискиот надзор не се утврдени неправилности и други повреди на закон или друг пропис или утврдените неправилности се отстранети во текот на вршењето на инспекцискиот надзор или во рокот утврден со решението од ставот (1) на овој член, инспекторот ја запира постапката, со констатација во записникот, согласно со закон.

(4) По исклучок од ставот (3) на овој член, инспекторот може да изрече инспекциска мерка со усно решение наведено во записникот, согласно со закон.

(5) Во случајот од ставот (4) на овој член, инспекторот е должен веднаш, а најдоцна во рок од осум дена, да донесе писмено решение за изрекување на инспекциска мерка, согласно со закон.

(6) Против решението од ставовите (1) и (5) на овој член, може да се изјави жалба во рок од 15 дена од денот на приемот на решението, до надлежниот орган за одлучување во втор степен, согласно со закон.

(7) Жалбата не го одлага извршувањето на решението од ставовите (1) и (5) на овој член.

(8) За изречените опомени надлежниот инспекциски орган води евиденција, на начин пропишан од страна на министерот надлежен за работите од областа на трудот.“.

Член 2

Членот 258-а се менува и гласи:

„(1) Ако надлежниот инспектор, утврди повреда на закон, друг пропис, колективен договор, договор за вработување и други акти, над чија примена врши инспекциски надзор, за која повреда има изречено инспекциска мерка согласно со членот 258 од овој закон, со решение ќе му нареди на работодавачот да донесе или поништи акт и преземе други дејствија со кои ќе ги отстрани утврдените неправилности и недостатоци.

(2) По исклучок, ако инспекторот утврди дека субјектот на инспекцискиот надзор сторил прекршок утврден во членот 264 од овој закон, е должен за сторениот прекршок да донесе решение со инспекциска мерка наредба.

(3) За постапувањето по донесеното решение, работодавачот е должен да го извести инспекторот на трудот.

(4) Против решението од ставовите (1) и (2) на овој член, може да се изјави жалба во рок од 15 дена од денот на приемот на решението, до надлежниот орган за одлучување во втор степен, согласно со закон.

(5) Жалбата не го одлага извршувањето на решението од ставовите (1) и (2) на овој член.“.

Член 3

Членот 259 се менува и гласи:

„(1) Ако надлежниот инспектор затекне на работа кај работодавач лице со кое не е засновал работен однос, согласно со закон и лицето не е пријавено во задолжително социјално осигурување, со решение ќе нареди на работодавачот, во рок од осум дена од денот на приемот на решението, со затеченото лице или со друго лице, без јавен оглас да заснова работен однос на неопределено време и во наредните три месеци да не го намали вкупниот број на вработени. Притоа, ќе му даде предлог за порамнување со издавање на прекршочен платен налог на одговорното лице или од него овластено лице кај работодавачот, согласно со Законот за прекршоците. Ако работодавачот не го прифати прекршочниот платен налог, надлежниот инспектор ќе поднесе барање за поведување на прекршочна постапка.

(2) Ако работодавачот го повтори прекршокот од ставот (1) на овој член, во рок од една година од денот на сторувањето на прекршокот, надлежниот инспектор со решение ќе забрани работа кај работодавачот во работната просторија, односно работниот простор, во траење од 15 дена и ќе поднесе барање за поведување на прекршочна постапка, согласно со закон.

(3) За време на забраната за работа на работодавачот од ставот (2) на овој член, работодавачот е должен на работниците да им исплатува надоместок на плата најмалку 90% од исплатената плата на работникот во претходниот месец и придонеси од плата и за време на забраната не смее да го намали бројот на вработените.

(4) Овластените службени лица се должни да водат евиденција за издадените прекршочни платни налози и за исходот на покренатите постапки.

(5) Во евиденцијата од ставот (4) на овој член се собираат, обработуваат и чуваат следниве податоци: име и презиме, односно назив на сторителот на прекршокот, живеалиште, односно престојувалиште, седиште, вид на прекршокот, број на прекршочниот платен налог кој му се издава и исходот на постапката.

(6) Личните податоци од ставот (5) на овој член се чуваат пет години од денот на внесување во евиденцијата.

(7) Министерот надлежен за работите од областа на трудот ја пропишува формата и содржината на прекршочниот платен налог.

(8) Против решението од ставовите (1) и (2) на овој член, може да се изјави жалба во рок од 15 дена од денот на приемот на решението, до надлежниот орган за одлучување во втор степен, согласно со закон.

(9) Жалбата не го одлага извршувањето на решението од ставот (2) на овој член.“.

Член 4

Членот 263 се менува и гласи:

„(1) Против решението на надлежниот инспектор, донесено согласно со членот 262 од овој закон, може да се изјави жалба во рок од 15 дена од денот на приемот на решението до надлежниот орган за одлучување во втор степен, согласно со закон.

(2) Жалбата против решението од ставот (1) на овој член не го одлага извршувањето.“.

Член 5

Членот 264 се менува и гласи:

„(1) Глоба во износ од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече на микро и мал работодавач-правно лице, глоба во износ од 1.000 до 2.000 евра во денарска противвредност на среден работодавач-правно лице и глоба во износ од 2.000 до 3.000 евра во денарска противвредност на голем работодавач-правно лице, ако:

- не обезбеди услови за безбедност на животот и здравјето на работниците во согласност со прописите за безбедност и здравје при работа (член 42);
- не го запознае работникот со мерките за безбедност и здравје при работа и не го обучи за нивната примена, согласно со прописите за безбедност и здравје при работа (член 32);
- не ги штити и почитува личноста, достоинството, приватноста на работникот и не се грижи за заштита на личните податоци на работникот (член 43 ставови (1) и (2) и член 44 ставови (1), (2), (3) и (4));
- го оневозможува или ќе се обиде да го оневозможи инспекторот на трудот во спроведувањето на инспекцискиот надзор (членови 256 и 257);
- не обезбеди заштита на правата во случај на пренесување на трговско друштво или делови на трговско друштво (членови од 68-а до 68-д);
- на работничка и наложи да врши подземни работи, на работничка, татко и посвоител на дете со потешки пречки во развојот, не им обезбеди право на посебна заштита во согласност со закон (членови од 160 до 171);
- на работници кои сè уште не наполниле 18 години возраст не им обезбеди заштита во согласност со закон (членови од 172 до 176);
- на инвалидите и повозрасните работници не им обезбеди заштита во согласност со закон (членови од 177 до 180) и
- организира работа на деца, ученици и студенти спротивно на овој закон (членови 250 и 251).

(2) Глоба во износ од 250 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на одговорното лице во правното лице кај микро и мал работодавач, глоба во износ од 400 евра во денарска противвредност кај среден работодавач и глоба во износ од 500 евра во денарска противвредност кај голем работодавач.

(3) Глоба во износ од 250 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на работодавач-физичко лице.

(4) За прекршоците од ставовите (1), (2) и (3) на овој член, прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.“.

Член 6

Членот 264-а се брише.

Член 7

Членот 265 се менува и гласи:

„(1) Глоба во износ од 200 до 400 евра во денарска противвредност ќе му се изрече на микро и мал работодавач-правно лице, глоба во износ од 300 до 600 евра во денарска противвредност на среден работодавач-правно лице, глоба во износ од 600 до 1.000 евра во денарска противвредност на голем работодавач-правно лице, ако:

- не е склучен договор за вработување меѓу работникот и работодавачот и работодавачот не го пријавил работникот во задолжително пензиско и инвалидско осигурување, здравствено осигурување и осигурување во случај на невработеност пред стапување на работникот на работа (член 13 ставови (1), (2), (3) и (7));
- договорот за вработување не се чува во работните простории во седиштето на работодавачот и не му е врачен примерок од договорот за вработување на работникот (член 15 ставови (2) и (3));
- склучи договор за вработување со лице кое не наполнило 15 години возраст и кое нема општа здравствена способност (член 18);
- склучи договор за вработување или овозможи работа на млади лица спротивно на членот 18 од овој закон или ако склучи договор за вработување спротивно на овој закон (член 19 ставови (1), (2) и (3));
- склучи договор за вработување со странец кој не ги исполнува условите определени со овој или со друг закон (член 20);
- не склучи договор со странски државјанин или лице без државјанство (член 20);
- објави јавен оглас и слободно работно место спротивно на овој закон (членови 22, 23 и 24);
- не го извести неизбраниот кандидат (член 27);
- при склучување на договор за вработување постапи спротивно на членот 25 од овој закон;
- договорот за вработување не ги содржи законските елементи (член 28);
- работодавачот направи измени на договор за вработување спротивно на овој закон (член 28-а ставови (2), (3) и (4));
- во договорот за вработување внесе одредби спротивни на закон и колективен договор (член 29);
- на работникот му наложи да врши други работни задачи спротивно на закон (член 30);
- определи конкурентска клаузула спротивно на закон (членови од 36 до 39);
- на работникот не му обезбеди работа за која е склучен договорот за вработување (член 40);
- не му обезбеди мирување на работниот однос, согласно со закон (член 45);
- не му го трансформира работниот однос согласно со закон (член 46);
- на сезонскиот работник не му ги обезбеди правата согласно со закон (член 47);
- на работникот кој работи со неполно работно време му наложи да работи подолго од договореното работно време (членови од 48 до 60);
- на приправникот не му обезбеди права, согласно со закон (членови 56 до 59);
- доколку изрече отказ на договорот за вработување (членови од 70 до 83);

- склучи спогодба спротивно на овој закон или го одјави работникот без спогодба (член 68);
- ако изрече парична казна спротивно на овој закон (членови 84 и 85);
- не ги почитува отказните рокови (членови 88 и 89);
- го откаже договорот за вработување по истекот на рокот од овој закон (член 94);
- не обезбеди информирање и консултирање на работникот во смисла на членовите 94-а и 95 од овој закон;
- не обезбеди права и не исплати испратнина согласно со закон (членови 96 и 97);
- не постапи по предупредувањето и откажувањето на договорот за вработување дадено од работникот (член 100);
- го откаже договорот за вработување спротивно на членот 101 од овој закон;
- не исплати плата, не уплати придонеси од плата и не исплати надоместоци согласно со закон и колективен договор (членови од 105 до 114);
- на работникот му нареди да работи со подолго работно време од работното време определено со закон, не води или неправилно води евиденција на работното време и на прекувремената работа, не исплати бонус на плата и не го извести инспекторот за воведување на прекувремена работа (членови 116, 117, 119 и 120);
- не го продолжи договорот за вработување (член 104);
- на работникот не му овозможи дополнителна работа, согласно со закон (член 121);
- не му овозможи право утврдено согласно со закон (член 122-а);
- организира работа во смени спротивно на закон (член 124-а);
- пресметува работно време спротивно на овој закон (член 126);
- не ги почитува прописите за прераспределбата и распоред на работното време (членови 123, 124 и 125);
- ноќната работа ја организира спротивно на членовите од 127 до 131 од овој закон, односно не го извести инспекторот за воведување на ноќна работа;
- на работникот не му обезбеди пауза за време на работното време, одмор меѓу два последователни дена, неделен и годишен одмор, во согласност со овој закон, не исплати надоместок за годишен одмор, не обезбеди платен одмор, не обезбеди неплатено отсуство, согласно со закон, не го врати работникот на работа по рокот за мирување на работниот однос, не му обезбеди отсуство заради образование утврден со овој закон и не издаде решение за годишен одмор (членови од 132 до 155);
- на синдикалниот претставник му ја намали платата или му го откаже договорот за вработување спротивно на овој закон (член 200);
- вршењето на работа во странство го организира спротивно на закон (членови 248, 249 и 249-а) и
- не постапи по решението на инспекторот за отстранување на повреда на закон или друг пропис или по налог на инспекторот за труд за забрана на работа (членови од 256 до 263).

(2) Глоба во износ од 150 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на одговорното лице во правното лице кај микро и мал работодавач, глоба во износ 300 евра во денарска противвредност кај среден работодавач и глоба во износ 400 евра во денарска противвредност кај голем работодавач.

(3) Глоба во износ од 250 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на работодавач-физичко лице.

(4) За изрекување на прекршочните санкции по ставовите (1), (2) и (3) на овој член, надлежна е прекршочна комисија, формирана од страна на министерот надлежен за работите од областа на трудот.

(5) Остварувањето на правото на правен лек против одлуката на прекршочната комисија од ставот (4) на овој член, се спроведува согласно со Законот за прекршоци.“.

Член 8

Членот 265-а се менува и гласи:

„(1) Глоба во износ од 200 до 300 евра во денарска протввредност ќе му се изрече на мал работодавач-правно лице, глоба во износ од 300 до 400 евра во денарска противвредност на среден работодавач-правно лице, глоба во износ од 400 до 600 евра во денарска противвредност на голем работодавач-правно лице, ако:
- не ги исполнува пропишаните и договорените услови за вршење на работата определени со закон, колективен договор, акт на работодавачот, односно барани од страна на работодавачот (член 19);
- на инспекторот за труд не му достави примерок од договорот за вработување за вршење на работа дома (член 50);
- работодавачот се обиде да оствари или остварува забранет надзор над синдикатот (член 195);
- не издаде потврда со список или издаде потврда со список со нецелосни податоци за работниците членови на синдикатот кои плаќаат членарина (член 213-в);
- работник кој организирал или учествувал во штрајк, организиран во согласност со закон, го стави во понеповолна положба со другите работници (член 239);
- откажувањето на договорот за вработување не биде изречено во писмена форма и содржина, согласно со закон и не биде врачен (членови 74 и 75);
- тогаш кога е должен не учествува во постапка за мирно решавање на работните спорови (членови 182 и 183) и
- склучи договор спротивно на членот 252 од овој закон.

(2) Глоба во износ од 100 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на одговорното лице во правното лице кај микро и мал работодавач, глоба во износ од 250 евра во денарска противвредност кај среден работодавач и глоба во износ од 350 евра во денарска противвредност кај голем работодавач.

(3) Глоба во износ од 200 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршокот од ставот (1) на овој член на работодавач-физичко лице.

(4) За изрекување на прекршочните санкции по ставовите (1), (2) и (3) на овој член, надлежна е прекршочна комисија, формирана од страна на министерот за труд и социјална политика.

(5) Остварувањето на правото на правен лек против одлуката на прекршочната комисија од ставот (4) на овој член, се спроведува согласно со Законот за прекршоци.“.

Член 9

Во членот 266 став (1) воведната реченица се менува и гласи:

„Глоба во износ од 800 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за сторен прекршок на синдикатот, односно синдикатот на повисоко ниво и на здружението на работодавачите, ако:“.

Член 10

Во членот 266-а став (1) зборовите: „264, 264-а,“ се бришат.

Ставот (2) се менува и гласи:

„За прекршоците утврдени во членовите 265 став (1) точка 1) и ставови (2) и (3) од овој закон, прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува прекршочниот орган во органот на државната управа надлежен за работите од областа на економијата, здравството и техничките работи.“.

Ставот 5 се менува и гласи:

„Остварувањето на правото на правен лек против одлуката на прекршочната комисија од ставот (4) на овој член, се спроведува согласно со Законот за прекршоците.“.

Член 11

Членот 266-в се менува и гласи:

„(1) Инспекторот од членот 261 за прекршоците од членовите 264, 265, 265-а и 266 од овој закон и инспекторот од членот 261-а, за прекршокот утврден во членот 265 став (1) алинеја 1 од овој закон, пред да поднесе барање за поведување на прекршочна постапка, е должен на одговорното лице или од него овластено лице кај работодавач, да му издаде прекршочен платен налог, согласно со Законот за прекршоците.

(2) Ако сторителот ја плати глобата во рок од осум дена од денот на издавањето на прекршочниот платен налог, ќе плати половина од предвидената глоба, а доколку не ја плати во предвидениот рок, овластеното службено лице ќе поднесе барање за поведување на прекршочна постапка до надлежниот орган.

(3) Формата и содржината на прекршочниот платен налог ја пропишува министерот за труд и социјална политика.“.

Член 12

Низ целиот текст на законот зборовите: „Република Македонија“ се заменуваат со зборовите: „Република Северна Македонија“.

Член 13

Подзаконските акти предвидени со овој закон ќе се донесат во рок од 30 дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 14

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Северна Македонија да утврди пречистен текст на Законот за работните односи.

Член 15

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

---

**L I G J**
**PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR MARRËDHËNIE PUNE**

Neni 1

Në Ligjin e Marrëdhënieve të Punës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2005, 106/2008,161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 110/19), neni 258 ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori kompetent përcakton se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka kryer kundërvajtjen e përcaktuar në nenet 265, 265-a dhe 266 të këtij ligji, është i detyruar për kundërvajtjen e kryer të përpilojë procesverbal, në pajtim me ligjin dhe me aktvendim subjektit të mbikëqyrjes inspektuese t'i shqiptojë masë inspektuese të vërejtjes dhe t'i caktojë afat në të cilin është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara.

(2) Aktvendimi sipas paragrafit (1) të këtij neni, miratohet menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditëve nga përgatitja e procesverbalit, në pajtim me ligjin.

(3) Kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nuk konstatohen parregullsi dhe shkelje të tjera të ligjit ose ndonjë rregulle tjetër ose parregullsitë e konstatuara janë evituar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese ose në afatin e përcaktuar me aktvendim sipas paragrafit (1) të këtij neni, inspektori e ndërpret procedurën, me konstatim në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni, inspektori mund të shqiptojë masë inspektuese me aktvendim me gojë të cekur në procesverbal, në pajtim me ligjin.

(5) Në rastin sipas paragrafit (4) të këtij neni, inspektori është i detyruar menjëherë, e më së voni në afat prej tetë ditëve, të miratojë aktvendim me shkrim për shqiptimin e masës inspektuese, në pajtim me ligjin.

(6) Kundër aktvendimit sipas paragrafëve (1) dhe (5) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit, në organin kompetent për vendosje në shkallën e dytë, në pajtim me ligjin.

(7) Ankesa nuk e prolongon realizimin e aktvendimit sipas paragrafëve (1) dhe (5) të këtij neni.

(8) Për vërejtjet e shqiptuara organi kompetent inspektues mban evidencë në mënyrën e përcaktuar nga ana e ministrit kompetent për çështjet e sferës së punës.

Neni 2

Neni 258-a ndryshohet dhe bëhet sç vijon:

"(1) Nëse inspektori kompetent, konstaton shkelje të ligjit, të rregullës tjetër, marrëveshjes kolektive, marrëveshjes për punësim dhe akteve të tjera, për zbatimin e të cilëve kryen mbikëqyrje inspektuese, për të cilën shkelje ka shqiptuar masë inspektuese në pajtim me nenin 258 të këtij ligji, me aktvendim do ta urdhërojë punëdhënësin të miratojë ose të anulojë akt dhe të ndërmarrë veprime të tjera me të cilat do t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e përcaktuara.

(2) Me përjashtim, nëse inspektori konstaton se subjekti i mbikëqyrjes inspektuese ka kryer kundërvajtje të përcaktuar në nenin 264 të këtij ligji, është i detyruar për kundërvajtjen e kryer të miratojë aktvendim me masë inspektuese të urdhëresës.

(3) Për veprimin sipas aktvendimit të miratuar, punëdhënësi është i detyruar ta njoftojë inspektorin e punës.

(4) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (1) dhe paragrafit (2) i këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit, në organin kompetent për vendosje në shkallën e dytë, në pajtim me ligjin.

(5) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.".

Neni 3

Neni 259 ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(1) Nëse inspektori kompetent në punë te punëdhënësi gjend ndonjë person me të cilin nuk është themeluar marrëdhënia e punës, në pajtim me ligjin, dhe personi nuk është i paraqitur në sigurimin e detyrueshëm social, me aktvendim do ta urdhërojë punëdhënësin, në afat prej tetë ditësh nga pranimi i aktvendimit, që me personin e gjetur ose me personin tjetër, pa konkurs publik, të themelojë marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe në tre muajt në vijim të mos e zvogëlojë numrin e përgjithshëm të të punësuarve. Pastaj, do t'i japë propozim për barazim me dhënie të urdhërpagesës kundërvajtëse personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij te punëdhënësi, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes. Nëse punëdhënësi nuk e pranon urdhërpagesën kundërvajtëse, inspektori kompetent do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje.

(2) Nëse punëdhënësi e përsërit kundërvajtjen sipas paragrafit (1) i këtij neni, në afat prej një viti nga dita e kryerjes së kundërvajtjes, inspektori kompetent me aktvendim do ta ndalojë punën te punëdhënësi në lokalin e punës, përkatësisht hapësirën e punës, në kohëzgjatje prej 15 ditësh dhe do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, në pajtim me ligjin.

(3) Gjatë kohës së ndalimit për punë të punëdhënësit sipas paragrafit (2) të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar punëtorëve t'u paguajë kompensim të rrogës së paku 90% nga rroga e paguar e punëtorit në muajin paraprak dhe kontributet e rrogës edhe gjatë kohës së ndalimit nuk guxon ta zvogëlojë numrin e të punësuarve.

(4) Personat e autorizuar zyrtarë janë të detyruar të mbajnë evidencë për urdhërpagesat e dhëna për kundërvajtje dhe për rezultatet e procedurave të ngritura.

(5) Në evidencën sipas paragrafit (4) të këtij neni grumbullohen, përpunohen dhe ruhen këto të dhëna: emri dhe mbiemri, përkatësisht titulli i kryerësit të kundërvajtjes, vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi, selia, lloji i kundërvajtjes, numri i urdhërpagesës kundërvajtëse që jepet edhe rezultati i procedurës.

(6) Të dhënat personale nga paragrafi (5) i këtij neni ruhen pesë vjet nga dita e futjes në evidencë.

(7) Ministri kompetent për çështjet nga sfera e punës e përcakton formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës kundërvajtëse.

(8) Kundër aktvendimit sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit, në organin kompetent për vendosje në shkallën e dytë, në pajtim me ligjin.

(9) Ankesa nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit sipas paragrafit (2) të këtij neni.".

Neni 4

Neni 263 ndryshon dhe bëhet siç vijon:

“(1) Kundër aktvendimit të inspektorit kompetent, të miratuar në pajtim me nenin 262 të këtij ligji, mund të deklarohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit në organin kompetent për vendosje në shkallën e dytë, në pajtim me ligjin.

(2) Ankesa kundër aktvendimit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk e prolongon zbatimin.”.

Neni 5

Neni 264 ndryshon dhe bëhet siç vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm -person juridik dhe gjobë në shumë prej 2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh – person juridik, nëse:

- nuk siguron kushte për siguri të jetës dhe shëndetit të punëtorëve në pajtim me rregullat për siguri dhe shëndet gjatë punës (neni 42);

- nuk e njofton punëtorin me masat për siguri dhe shëndet gjatë punës dhe nuk e trajnon për zbatimin e tyre, në pajtim me rregullat për siguri dhe shëndet gjatë punës (neni 32);

- nuk e mbron dhe respekton personalitetin, dinjitetin, privatësinë e punëtorit dhe nuk kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale të punëtorit (neni 43 paragrafët (1) dhe (2) dhe neni 44 paragrafët (1), (2), (3) dhe (4));

- e pamundëson ose do të orvatet ta pamundësojë inspektorin e punës në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese (nenet 256 dhe 257);

- nuk siguron mbrojtje të të drejtave në rast të bartjes së shoqërisë tregtare ose pjesës së shoqërisë tregtare (nenet 68-a deri në 68 -d);

- punëtoren e urdhëron të kryejë punë nëntokësore, punëtores, babait dhe adoptuesit të fëmijës me pengesa më të rënda në zhvillim, nuk u siguron të drejtë të mbrojtjes së posaçme në pajtim me ligjin (nenet 160 deri në 171);

- punëtorëve, të cilët ende nuk i kanë mbushur 18 vjet, nuk u siguron mbrojtje në pajtim me ligjin (nenet nga 172 deri në 176);

- invalidëve dhe punëtorëve më të moshuar nuk u siguron mbrojtje në pajtim me ligjin (177 deri 180) dhe

- organizon punë të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në kundërshtim me këtë ligj (nenet 250 dhe 251).

(2) Gjobë në shumë prej 250 në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni, personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënës mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësit i mesëm dhe gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënës i madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë në denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni punëdhënësit – person fizik.

(4) Për kundërvajtjet sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.”

Neni 6

Neni 264-a fshihet.

Neni 7

Neni 265 ndryshon dhe bëhet siç vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 200 deri në 400 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet punëdhënësit mikro dhe të vogël - person juridik, gjobë në shumë prej 300 deri në 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm -person juridik dhe gjobë në shumë prej 600 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh – person juridik, nëse:

- nuk është lidhur marrëveshje për punësim ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit dhe punëdhënësi nuk e ka paraqitur punëtorin në sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor, sigurim shëndetësor dhe sigurim në rast të papunësisë para hyrjes së punëtorit në punë (neni 13 paragrafët (1), (2), (3) dhe (7));

- marrëveshja për punësim nuk ruhet në mjediset e punës në selinë e punëdhënësit dhe punëtorit nuk i është dorëzuar ekzemplari i marrëveshjes për punësim (neni 15 paragrafët (2) dhe (3));

- lidh marrëveshje për punësim me personin i cili nuk e ka arritur moshën 15 vjeçare dhe i cili nuk ka aftësi të përgjithshme shëndetësore (neni 18);

- lidh marrëveshje për punësim ose mundëson punë për persona të rinj në kundërshtim me nenin 18 të këtij ligji ose nëse lidh marrëveshje për punësim në kundërshtim me këtë ligj (neni 19 paragrafët (1), (2) dhe (3));

- lidh marrëveshje për punësim me person të huaj i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ose me ligj tjetër (neni 20);

- nuk lidh marrëveshje me shtetas të huaj ose person pa shtetësi (neni 20);

- shpall konkurs publik dhe vend të lirë të punës në kundërshtim me këtë ligj (nenet 22, 23 dhe 24);

- nuk e njofton kandidatin e pazgjedhur (neni 27);

- gjatë lidhjes së marrëveshjes për punësim vepron në kundërshtim me nenin 25 të këtij ligji;

- marrëveshje për punësim nuk i përmban elementet ligjore (neni 28);

- punëdhënësi bën ndryshime në marrëveshjen për punësim në kundërshtim me këtë ligj (neni 28-a paragrafët (2),(3) dhe (4));

- në marrëveshjen për punësim fut dispozita në kundërshtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive (neni 29);

- punëtorin e urdhëron të kryejë detyra të tjera të punës në kundërshtim me ligjin (neni 30);

- përcakton klauzolë konkurruese në kundërshtim me ligjin (nenet prej 36 deri në 39),

- punëtorit nuk i siguron punë për të cilën është lidhur marrëveshja për punësim (neni 40);

- nuk i siguron pezullim të marrëdhënies së punës në pajtim me ligjin (neni 45);

- nuk ia transformon marrëdhënien e punës në pajtim me ligjin (neni 46);

- punëtorit sezonal nuk ia siguron të drejtat në pajtim me ligjin (neni 47);

-punëtorit i cili punon me orar jo të plotë të punës i urdhëron të punojë më gjatë se orari i kontraktuar i punës (nenet prej 48 deri 60);

- praktikantit nuk i siguron të drejta në pajtim me ligjin (nenet 56 deri 59);

- nëse shqipton prishje të marrëveshjes për punësim (nenet prej 70 deri 83);

- lidh marrëveshje në kundërshtim me këtë ligj ose e çregjistron punëtorin pa marrëveshje (neni 68);

- nëse shqipton dënim me para në kundërshtim me këtë ligj (nenet 84 dhe 85);

- nuk i respekton afatet e largimeve nga puna (nenet 88 dhe 89);

- nuk e prish marrëveshjen për punësim pas kalimit të afatit sipas këtij ligji (neni 94);

- nuk siguron informim dhe konsultim të punëtorit në kuptim të neneve 94-a dhe 95 të këtij ligji;

-nuk siguron të drejta dhe nuk bën pagesë përcjellëse në pajtim me ligjin (nenet 96 dhe 97);

- nuk vepron sipas paralajmërimit dhe prishjes së marrëveshjes për punësim të dhënë nga punëtori (neni 100);

- e prish marrëveshjen për punësim në kundërshtim me nenin 101 të këtij ligji;

- nuk paguan rrogë, nuk paguan kontribute të rrogës dhe nuk paguan kompensime në pajtim me ligjn dhe marrëveshjen kolektive (nenet 105 dhe 114);

- punëtorit i urdhëron të punojë me orar më të gjatë pune se ai që është përcaktuar me ligj, nuk mban ose në mënyrë të parregullt mban evidencë të orarit të punës dhe të punës jashtë orarit, nuk paguan bonus të rrogës dhe nuk e njofton inspektorin për vendosjen e punës jashtë orarit (nenet 116, 117, 119 dhe 120);

- nuk e vazhdon marrëveshjen për punësim (neni 104);

- punëtorit nuk i mundëson punë plotësuese, në pajtim me ligjin (neni 121);

- nuk i mundëson të drejtë të përcaktuar me ligjin (neni 122-a);

- organizon punë në ndërrime në kundërshtim me ligjin (neni 126);

- nuk i respekton rregullat për rindarjen dhe orarin e kohës së punës (nenet 123, 124 dhe 125);

- punën gjatë natës e organizon në kundërshtim me nenet 127 deri 131 të këtij ligji, përkatësisht nuk e njofton inspektorin për vendosjen e punës gjatë natës;

- punëtorit nuk i siguron pauzë gjatë orarit të punës, pushim ndërmjet dy ditëve të njëpasnjëshme, pushim javor dhe vjetor, në pajtim me këtë ligj, nuk paguan kompensim për pushim vjetor, nuk siguron pushim të paguar, nuk siguron mungesë pa pagesë, në pajtim me ligjin, nuk e kthen punëtorin në punë pas afatit për pezullim të marrëdhënies së punës, nuk i siguron mungesë për shkak të arsimit të përcaktuar me këtë ligj dhe nuk lëshon aktvendim për pushim vjetor (nenet 132 dhe 155);

- përfaqësuesit të sindikatës ia zvogëlon rrogën ose ia prish marrëveshjen për punësim në kundërshtim me këtë ligj (neni 200);

- kryerjen e punës në vend të huaj e organizon në kundërshtim me ligjin (nenet 248, 249 dhe 249-a) dhe

- nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit për mënjanimin e shkeljes së ligjit ose rregullës tjetër ose sipas urdhëresës së inspektorit të punës për ndalim të punës (nenet 256 dhe 263).

(2) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i mesëm dhe gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i madh.

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(4) Për shqiptimin e sanksioneve kundërvajtëse sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, kompetent është komisioni kundërvajtës, i formuar nga ana e ministrit kompetent për çështjet nga sfera e punës.

(5) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër vendimit të komisionit kundërvajtës sipas paragrafit (4) të këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes."

Neni 8

Neni 265-a ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(1) Gjobë në shumë prej 200 deri 300 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet punëdhënësit të vogël - personit juridik, gjobë në shumë prej 300 deri 400 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të mesëm - personit juridik, gjobë në shumë prej 400 deri 600 euro në kundërvlerë me denarë punëdhënësit të madh -personit juridik, nëse:

- nuk i plotëson kushtet e përcaktuara dhe kontraktuese për kryerjen e punëve të përcaktuara me ligj, marrëveshjen kolektive, aktin e punëdhënësit, përkatësisht të kërkuara nga punëdhënësi (neni 19);

- inspektorit të punës nuk i dorëzohet ekzemplar i marrëveshjes për punësim për kryerjen e punëve në shtëpi (neni 50);

- punëdhënësi mundohet të realizojë ose realizon mbikëqyrje të ndaluar mbi sindikatën (neni 195);

- nuk jep vërtetim me listë ose jep vërtetim me listë me të dhëna jo të plota për punëtorët, anëtarë të sindikatës të cilët paguajnë anëtarësim (neni 213-v);

-punëtorin i cili ka organizuar ose ka marrë pjesë në grevën e organizuar në pajtim me ligjin, e vë në pozitë të palakmueshme me punëtorët e tjerë (neni 239);

- prishja e marrëveshjes për punësim nuk shqiptohet në formë dhe përmbajtje të shkruar, në pajtim me ligjin dhe nuk dorëzohet (neni 74 dhe 75);

- atëherë kur është i detyruar nuk merr pjesë në procedurë për zgjidhje paqësore të kontesteve të punës (nenet prej 182 dhe 183) dhe

- lidh marrëveshje në kundërshtim me nenin 252 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni personit përgjegjës në personin juridik te punëdhënësi mikro dhe i vogël, gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i mesëm dhe gjobë në shumë prej 350 euro në kundërvlerë me denarë te punëdhënësi i madh.

(3) Gjobë në shumë prej 200 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - personit fizik.

(4) Për shqiptimin e sanksioneve për kundërvajtje sipas paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni, kompetente është komisioni për kundërvajtje, i formuar nga ministri i Punës dhe I Politikës Sociale.

(5) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër vendimit të komisionit për kundërvajtje nga paragrafi (4) i këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.".

Neni 9

Në nenin 266 në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(1) Gjobë në shumë prej 800 deri 1000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtjen e kryer sindikatës, përkatësisht sindikatës në nivel më të lartë dhe shoqatës së punëdhënësve, nëse:"

Neni 10

Në nenin 266-a në paragrafin (1) fjalët: "264, 264-a" fshihen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 265 paragrafi (1) pika 1) dhe paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion kundërvajtës shqipton organi për kundërvajtje në organin e administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i ekonomisë, shëndetësisë dhe punëve teknike.".

Paragrafi 5 ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(5) Realizimi i të drejtës së mjetit juridik kundër vendimit të komisionit për kundërvajtje sipas paragrafit (4) të këtij neni, zbatohet në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.".

Neni 11

Neni 266-v ndryshohet dhe bëhet siç vijon:

"(1) Inspektori, sipas nenit 261 për kundërvajtjet sipas neneve 264, 265, 265-a dhe 266 të këtij neni dhe inspektori sipas neni 261-a, për kundërvajtjen e përcaktuar në nenin 265 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të këtij ligji, para se të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje, është i detyruar që personit përgjegjës ose personit të autorizuar prej tij te punëdhënësi, t'i japë urdhërpagesë kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin e Kundërvajtjes.

(2) Nëse kryerësi e paguan gjobën në afat prej tetë ditësh nga dhënia e urdhërpagesës për kundërvajtje, do ta paguajë gjysmën e gjobës së paraparë, e nëse nuk e paguan në afatin e paraparë, personi i autorizuar zyrtar do të paraqesë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje në organin kompetent.

(3) Formën dhe përmbajtjen e urdhërpagesës për kundërvajtje e përcakton ministri i Punës dhe i Politikës Sociale.".

Neni 12

Në tërë tekstin e ligjit fjalët: "Republika e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "Republika e Maqedonisë së Veriut".

Neni 13

Aktet nënligjore të parapara me këtë ligj do të miraton në afat prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 14

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut të konstatojë tekstin e zbardhur të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

---

**3515.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**У К А З**
**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА НА ФИЗИЧКИ ЛИЦА КОИ ВРШАТ САМОСТОЈНА ДЕЈНОСТ ПОГОДЕНИ ОД ЗДРАВСТВЕНО-ЕКОНОМСКАТА КРИЗА ПРЕДИЗВИКАНА ОД ВИРУСОТ COVID-19, ЗА МЕСЕЦИТЕ ОКТОМВРИ, НОЕМВРИ И ДЕКЕМВРИ 2020 ГОДИНА**

Се прогласува Законот за финансиска поддршка на физички лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, за месеците октомври, ноември и декември 2020 година,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 6 ноември 2020 година.

Бр. 08-3921/1
6 ноември 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
**Стево Пендаровски,** с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi,** с.р.

**З А К О Н**
**ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА НА ФИЗИЧКИ ЛИЦА КОИ ВРШАТ САМОСТОЈНА ДЕЈНОСТ ПОГОДЕНИ ОД ЗДРАВСТВЕНО-ЕКОНОМСКАТА КРИЗА ПРЕДИЗВИКАНА ОД ВИРУСОТ COVID-19, ЗА МЕСЕЦИТЕ ОКТОМВРИ, НОЕМВРИ И ДЕКЕМВРИ 2020 ГОДИНА**

Член 1

(1) Со овој закон се уредуваат условите и постапката за добивање на финансиска поддршка на физичките лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, за месеците октомври, ноември и декември 2020 година.

(2) „Физичко лице кое врши самостојна дејност“ е трговец поединец, физичко лице кое врши земјоделска дејност, лице кое врши занаетчиска дејност и лице кое врши услуги, кое остварува доход од вршење дејност и е запишано во соодветен регистар.

Член 2

(1) Финансиската поддршка на физичките лица кои вршат дејност од членот 1 став (2) од овој закон ќе се спроведува преку Владина Програма за финансиска поддршка на физичките лица кои вршат дејност погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19 за исплата на финансиски средства на трансакциска сметка преку која физичкото лице барател на финансиска поддршка за исплата на финансиските средства за месеците октомври, ноември и декември 2020 година врши трансакции за дејноста (во натамошниот текст: физичкото лице кое врши самостојна дејност - барател на финансиска поддршка).

(2) Предмет на финансиска поддршка од ставот (1) на овој член е исплата на финансиски средства за месеците октомври, ноември и декември 2020 година, во износ од 17.410 денари месечно за физичкото лице кое врши самостојна дејност - барател на финансиска поддршка.

Член 3

(1) Физичкото лице кое врши самостојна дејност - барател на финансиска поддршка поднесува Барање за финансиска поддршка за исплата на финансиски средства со Изјава за исполнетост на условите од ставот (3) на овој член до Управата за јавни приходи. Формата и содржината на Барањето за финансиска поддршка за исплата на финансиски средства ги пропишува министерот за финансии.

(2) Барањето од ставот (1) на овој член, физичко лице кое врши самостојна дејност -барател на финансиска поддршка го поднесува преку системот е-персонален данок на Управата за јавни приходи до 10-ти во месецот за претходниот месец, а комплетноста на Барањето го потврдува Управата за јавни приходи, во рок од три дена од денот на приемот на барањето.

(3) Кон Барањето од ставот (2) на овој член, физичкото лице кое врши самостојна дејност и се оданочува по вистински доход - барател на финансиска поддршка дава Изјава за исполнетоста на условите од ставот (4) на овој член и членовите 4 и 5 од овој закон, а физичко лице кое врши самостојна дејност и се оданочува според утврден годишен паушален нето доход дава Изјава за исполнетоста на условите од членовите 4 и 5 од овој закон.

(4) За користење на финансиската поддршка за месеците октомври, ноември и декември 2020 година физичкото лице кое врши самостојна дејност - барател на финансиска поддршка, а се оданочува според вистински доход, треба:

- месечниот просек на вкупните приходи од редовното работење остварени во периодот од април 2020 година заклучно со месец септември 2020 година, октомври 2020 година или ноември 2020 година да се намалени најмалку за 30% во однос на месечниот просек на вкупните приходи од редовното работење остварени во периодот од месец април 2019 година заклучно со месец септември 2019 година, октомври 2019 година или ноември 2019 година. За физичко лице кое врши самостојна дејност - барател на финансиска поддршка регистрирано после септември 2019 година, намалувањето на вкупните приходи од редовното работење остварени во месец септември 2020 година, октомври 2020 година или ноември 2020 година да изнесува најмалку 30% во однос на месечниот просек на вкупните приходи од редовното работење остварени од денот на запишувањето во соодветен регистар до месецот кој му претходи на месецот за кој се бара финансиската поддршка. За физичко лице кое во 2020 година се оданочува по вистински доход, а во 2019 година се оданочувало според утврден годишен паушален нето доход, намалувањето на вкупните приходи од редовното работење остварени во месец септември 2020 година, октомври 2020 година или ноември 2020 година да изнесува најмалку 30% во однос на месечниот просек на вкупните приходи од редовното работење остварени од моментот кога физичкото лице кое врши самостојна дејност отпочнало да се оданочува по вистински доход до месецот кој му претходи на месецот за кој се бара финансиската поддршка.

Член 4

Финансиска поддршка не може да оствари физичко лице вршител на самостојна дејност кое се оданочува по вистински доход и кое во 2019 година на годишно ниво има остварено нето доход пред оданочување во износ поголем од 478.800 денари, односно физичко лице кое врши самостојна дејност и се оданочува според утврден годишен паушален нето доход и кое во 2019 година има утврден годишен паушален нето доход поголем од 478.800 денари.

Член 5

За времетраење на финансиската поддршка согласно со овој закон и четири месеци по месецот за кој се користи финансиската помош, физичкото лице кое врши самостојна дејност – корисник на финансиска поддршка не може да престане со вршење на дејноста, освен во случај на пензионирање и смрт на физичкото лице.

Член 6

(1) Управата за јавни приходи до 15-ти во месецот за претходниот месец ја известува Владата на Република Северна Македонија за физичките лица кои вршат самостојна дејност - баратели на финансиска поддршка, кои ги исполниле условите за финансиска поддршка за исплата на финансиски средства.

(2) Износот на финансиска поддршка од членот 2 став (2) од овој закон, се исплатува до 20-ти во месецот за претходниот месец согласно со Програмата за финансиска поддршка на физички лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено - економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, на трансакциска сметка преку која физичкото лице кое врши самостојна дејност врши трансакции за дејноста, за исплата на финансиски средства за месеците октомври, ноември и декември 2020 година, согласно со известувањето на Управата за јавни приходи.

(3) За исплата на финансиската поддршка од ставот (1) на овој член физичко лице кое врши самостојна дејност и се оданочува по вистински доход - барател на финансиска поддршка треба да ги исполни условите од членот 3 став (4) и членовите 4 и 5 од овој закон, а физичко лице кое врши самостојна дејност и се оданочува според утврден годишен паушален нето доход треба да го исполни условите од членовите 4 и 5 од овој закон.

Член 7

Физичкото лице кое врши самостојна дејност и кое користело финансиска поддршка за исплата на финансиски средства согласно со овој закон должно е да ги

врати добиените финансиски средства во целост, заедно со камата утврдена согласно со Законот за даночна постапка, доколку по извршена контрола од страна на Управата за јавни приходи и/или Државниот инспекторат за труд се утврди дека физичкото лице кое врши самостојна дејност не ги исполнило условите од членот 3 став (4) и членовите 4 и 5 од овој закон.

Член 8

(1) Физичкото лице кое врши самостојна дејност и се оданочува по вистински доход кое го искористило правото на финансиска поддршка согласно со овој закон има обврска примените финансиски средства да ги врати во Буџетот на Република Северна Македонија, но најмногу до износот од 50% од износот на искажаниот финансиски резултат за 2020 година, пред оданочување во Билансот на приходи и расходи (образец Б), зголемен за непризнаените расходи за даночни цели од Годишниот даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност, за што поднесува Барање за пресметување на износот за враќање на примената финансиска поддршка до Управата за јавни приходи најдоцна до рокот за поднесување на Годишниот даночниот биланс за 2020 година.

(2) Формата и содржината на Барањето за пресметување на износот на враќање на примената финансиска поддршка од ставот (1) на овој член ги пропишува министерот за финансии.

(3) Враќањето на износот од ставот (1) на овој член ќе се изврши на три месечни рати, без камата, во месеците октомври, ноември и декември 2021 година.

(4) Физичкото лице кое врши самостојна дејност и се оданочува по вистински доход кое го искористило правото на финансиска поддршка согласно со овој закон и кое не искажало даночна основа во Годишниот Даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност „образец ДЛД-ДБ“ износот на примена финансиска поддршка нема да ја врати во Буџетот на Република Северна Македонија, доколку нема обврски по основ на неплатени даноци и придонеси.

Член 9

За физичкото лице кое врши самостојна дејност-барател на финансиска поддршка кое дало Изјава согласно со членот 3 став (3) од овој закон, а не ги исполнило условите од членот 3 став (4) и членовите 4 и 5 од овој закон, ќе се применуваат одредбите од Кривичниот законик.

Член 10

Физичкото лице кое врши самостојна дејност и се оданочува по вистински доход доколку било корисник на финансиска помош согласно со овој закон и согласно со Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на физичките лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19 за време на вонредна состојба („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 92/20 и 156/20), износот на финансиска поддршка за кој има обврска согласно членот 8 од овој закон и согласно со членот 8 од Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на физичките лица кои вршат самостојна дејност погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19 за време на вонредна состојба („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 92/20 и 156/20) да го врати во Буџетот на Република Северна Македонија, не може кумулативно да го надмине износот од 50% од износот на искажаниот финансиски резултат за 2020 година, пред оданочување во Билансот на приходи и расходи (образец Б), зголемен за непризнаените расходи за даночни цели од Годишниот даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност.

Член 11

Подзаконските акти утврдени во овој закон ќе се донесат во рок од десет дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 12

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

---

**L I G J**
**I MBËSHTETJES FINANCIARE TË PERSONAVE FIZIKË QË KRYEJNË VEPRIMTARI TË PAVARUR, TË PREKUR NGA KRIZA EKONOMIKE SHËNDETËSORE, E SHKAKTUAR NGA VIRUSI COVID-19, PËR MUAJT TETOR, NËNTOR DHE DHJETOR 2020**

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedura për marrjen e mbështetjes financiare të personave fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur, të prekur nga kriza shëndetësore-ekonomike, e shkaktuar nga virusi COVID-19, për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020.

(2) Personi fizik që kryen veprimtari të pavarur" është tregtar individual, personi fizik që kryen veprimtari bujqësore, personi që kryen veprimtari zejtare dhe personi që kryen shërbime, i cili realizon të ardhura nga ushtrimi i veprimtarisë dhe është i regjistruar në regjistrin përkatës.

Neni 2

(1) Mbështetja financiare e personave fizikë që kryejnë veprimtari sipas nenit 1 paragrafi (2) të këtij ligji, zbatohet nëpërmjet Programit qeveritar për mbështetjen financiare të personave fizikë që kryejnë veprimtari, të prekur nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga virusi COVID-19, për pagesë të mjeteve financiare në llogari transaksioni nëpërmjet së cilës personi fizik, kërkues i mbështetjes financiare për pagesën e mjeteve financiare për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, kryen transaksione për veprimtarinë (në tekstin e mëtejshëm: Personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur - kërkues i përkrahjes financiare).

(2) Lëndë e mbështetjes financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni është pagesa e mjeteve financiare për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, në shumë prej 17,410 denarë në muaj për personin fizik që kryen veprimtari të pavarur – kërkues i mbështetjes financiare.

Neni 3

(1) Personi fizik që kryen veprimtari të pavarur – kërkues i mbështetjes financiare paraqet kërkesë për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare me Deklaratë për përmbushjen e kushteve sipas paragrafit (3) të këtij neni në Drejtorinë e të Hyrave Publike. Forma dhe përmbajtja e kërkesës për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare përcaktohet nga ministri i Financave.

(2) Kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni, personi fizik që kryen veprimtari të pavarur –kërkues i mbështetjes financiare e paraqet nëpërmjet sistemit të e-tatimit personal

në Drejtorinë e të Hyrave Publike deri më datë 10 të muajit për muajin paraprak, ndërkaq kërkesa nëse është e kompletuar e konfirmon Drejtoria e të Hyrave Publike, në afat prej trt ditësh nga marrja e kërkesës.

(3) Kërkesës, sipas paragrafi (2) të këtij neni, personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet mbi të ardhurat reale – kërkuesi për mbështetje financiare i bashkëngjit deklaratë për përmbushjen e kushteve sipas paragrafit (4) të këtij neni dhe nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, kurse personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet sipas të ardhurave vjetore neto të përcaktuar në mënyrë paushale, jep deklaratë për përmbushjen e kushteve sipas neneve 4 dhe 5 të këtij ligji.

(4) Për të shfrytëzuar mbështetje financiare për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur - kërkues i mbështetjes financiare dhe tatohet sipas të ardhurave reale, duhet që:

- mesatarja mujore e të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara në perudhën nga muaji prill 2020 përmbyllur me muajin shtator 2020, tetor 2020, ose nëntor 2020 të jenë të zvogëluara së paku për 30% në lidhje me mesataren mujore të të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara në periudhën nga muaji prill 2019 përmbyllur me muajin shtator 2019, muajin tetor 2019 ose nëntor 2019. Për personin fizik i cili kryen veprimtari të pavarur – kërkues i mbështetjes financiare të regjistruar pas muajit shtator 2019, zvogëlimi i të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara në muajin shtator 2020, muajin tetor 2020 ose muajin nëntor 2020, të jetë së paku 30% në lidhje me mesataren mujore të të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara nga dita e regjistrimit në regjistrin përkatës deri në muajin i cili i paraprin muajit për të cilin kërkohet mbështetja financiare. Për personin fizik, i cili në vitin 2020 tatimohet sipas të ardhurave të vërteta, ndërkaq në vitin 2019 është tatimuar sipas neto të ardhurave paushalle vjetore të përcaktuara, zvogëlimi i të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara në muajin shtator 2020, muajin tetor 2020 dhe muajin nëntor 2020, të jetë së paku 30% në lidhje me mesataren mujore të të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara nga momenti kur personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur ka filluar të tatimohet sipas të ardhurave të vërteta deri në muajin që i paraprin muajit për të cilën kërkohet mbështetje financiare.

Neni 4

Mbështetje financiare nuk mund të realizojë personi fizik që kryen veprimtari të pavarur që tatohet me të ardhura reale dhe i cili në vitin 2019 në nivel vjetor ka realizuar të ardhura vjetore neto para tatimit në shumë prej më shumë se 478.800 denarë, respektivisht person fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet sipas paushalit vjetor të përcaktuar të të ardhurave neto, për të cilin në vitin 2019 ka caktuar paushal vjetor neto të të ardhurave më të mëdha se 478,800 denarë.

Neni 5

Për kohëzgjatjen e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj dhe katër muaj pas muajit për të cilin shfrytëzohet ndihma financiare, personi fizik që kryen veprimtari të pavarur – shfrytëzues i mbështetjes financiare nuk mund të ndalojë kryerjen e veprimtarisë, përveç në rast të pensionimit dhe vdekjes së personit fizik.

Neni 6

(1) Drejtoria e të Hyrave Publike deri në datën 15 të muajit për muajin paraprak e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për personat fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur - kërkues të mbështetjes financiare, të cilët kanë përmbushur kushtet për mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare.

(2) Shuma e mbështetjes financiare sipas nenit 2 paragrafi (2) të këtij ligji do të paguhet deri më 20 të muajit për muajin paraprak në përputhje me programin për mbështetje financiare të personave fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur të prekur nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga Virusi COVID-19, në llogari transaksioni nëpërmjet së cilës personi fizik që kryen veprimtari të pavarur kryen transaksione për veprimtarinë, për pagesën e mjeteve financiare për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, në përputhje me njoftimin e Drejtorisë së të Hyrave Publike.

(3) Për pagimin e mbështetjes financiare sipas paragrafit (1) të këtij neni, personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet mbi të ardhurat reale – kërkues i mbështetjes financiare duhet t'i përmbushë kushtet sipas nenit 3 paragrafi (4) dhe nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, kurse personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet sipas të ardhurave neto vjetore të përcaktuar paushal duhet t'i përmbushë kushtet sipas neneve 4 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 7

Personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe i cili ka shfrytëzuar mbështetje financiare për pagimin e mjeteve financiare në pajtim me këtë ligj, është i detyruar që t'i kthejë mjetet e marra financiare në tërësi, së bashku me kamatën e përcaktuar në përputhje me Ligjin e Procedurës Tatimore, nëse pas kontrollit të kryer nga ana e Drejtorisë së të Hyrave Publike dhe/ose Inspektoratit Shtetëror të Punës konstatohet se personi fizik që kryen veprimtari të pavarur nuk i ka përmbushur kushtet sipas nenit 3 paragrafi (4) dhe nenet 4 dhe 5 të këtij ligji.

Neni 8

(1) Personi fizik që kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet mbi të ardhurat reale, i cili e ka shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, është i detyruar që mjetet e marra financiare t'i kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por më së shumti deri në shumën 50% të shumës së rezultatit të deklaruar financiar për vitin 2020, para tatimimit në bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve (formulari B), i rritur për shpenzimet e papranuara për qëllime tatimore nga bilanci vjetor tatimor për përcaktimin e tatimit mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë së pavarur, për çfarë paraqet kërkesë për llogaritjen e shumën për kthimin e mbështetjes financiare të marrë në Drejtorinë e të Hyrave Publike më së voni deri në afatin për dërgimin e bilancit vjetor tatimor për vitin 2020.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për përllogaritjen e shumës së kthimit të mbështetjes financiare të marrë sipas paragrafit (1) të këtij neni i përcakton ministri i Financave.

(3) Kthimi i shumës sipas paragrafit (1) të këtij neni do të bëhet në tri këste mujore, pa kamatë, në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2021.

(4) Personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet mbi të ardhurat reale, i cili e ka shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare në përputhje me këtë ligj dhe i cili nuk ka shprehur bazë tatimore në bilancin vjetor tatimor për përcaktimin e tatimit mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë së pavarur "formulari DLD- DB " shumën e mbështetjes financiare të marrë nuk do ta kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse nuk ka detyrime në bazë të kontributeve dhe tatimeve të papaguara.

Neni 9

Për personin fizik që kryen veprimtari të pavarur - kërkues i mbështetjes financiare i cili ka dhënë deklaratë në pajtim me nenin 3 paragrafi (3) të këtij ligji, ndërkaq nuk i ka përmbushur kushtet sipas nenit 3 paragrafi (4) dhe nenet 4 dhe 5 të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e Kodit Penal.

Neni 10

Personi fizik i cili kryen veprimtari të pavarur dhe tatohet mbi të ardhurat reale nëse ka qenë shfrytëzues i ndihmës financiare në përputhje me këtë ligj dhe në përputhje me dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare të personave fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur, të prekur nga kriza shëndetësore-ekonomike e shkaktuar nga koronavirusi COVID-19 gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 92/20 dhe 156/20) shuma e mbështetjes financiare për të cilën ka detyrim në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe në përputhje me nenin 8 të dekretit me fuqi ligjore për mbështetjen financiare të personave fizikë që kryejnë veprimtari të pavarur të prekur nga kriza shëndetësore dhe ekonomike e shkaktuar nga koronavirusi COVID-19 gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 92/20 dhe 156/20) ta kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nuk mund të kalojë në mënyrë kumulative shumën prej 50% të shumës së rezultatit financiar të deklaruar për vitin 2020, para tatimimit në bilancin e të ardhurave dhe shpenzimeve (formulari B) , i rritur për shpenzimet e papranuara për qëllime tatimore nga bilanci vjetor tatimor për përcaktimin e tatimit mbi të ardhurat nga kryerja e veprimtarisë së pavarur.

Neni 11

Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë ligj do të miratohen në afat prej dhjetë ditëve nga hyrja në fuqi të këtij ligji.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

---

**3516.**

Врз основа на членот 75, ставови 1 и 2 од Уставот на Република Северна Македонија, претседателот на Република Северна Македонија и претседателот на Собранието на Република Северна Македонија издаваат

**У К А З**
**ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА НА РАБОТОДАВАЧИТЕ ПОГОДЕНИ ОД ЗДРАВСТВЕНО-ЕКОНОМСКАТА КРИЗА ПРЕДИЗВИКАНА ОД ВИРУСОТ COVID-19, ЗАРАДИ ИСПЛАТА НА ПЛАТИТЕ ЗА МЕСЕЦИТЕ ОКТОМВРИ, НОЕМВРИ И ДЕКЕМВРИ 2020 ГОДИНА**

Се прогласува Законот за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците октомври, ноември и декември 2020 година,

што Собранието на Република Северна Македонија го донесе на седницата одржана на 6 ноември 2020 година.

Бр. 08- 3922/1
6 ноември 2020 година
Скопје

Претседател на Република
Северна Македонија,
**Стево Пендаровски,** с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Северна Македонија,
м-р **Talat Xhaferi,** с.р.

**З А К О Н**
**ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА НА РАБОТОДАВАЧИТЕ ПОГОДЕНИ ОД ЗДРАВСТВЕНО-ЕКОНОМСКАТА КРИЗА ПРЕДИЗВИКАНА ОД ВИРУСОТ COVID-19, ЗАРАДИ ИСПЛАТА НА ПЛАТИТЕ ЗА МЕСЕЦИТЕ ОКТОМВРИ, НОЕМВРИ И ДЕКЕМВРИ 2020 ГОДИНА**

Член 1

(1) Со овој закон се уредуваат условите и постапката за добивање на финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19, заради исплата на платите на работниците за месеците октомври, ноември и декември 2020 година.

(2) „Работодавач“ во смисла на овој закон е секој правен субјект кој вработува работници врз основа на договор за вработување, физичко лице кое вработува работници врз основа на договор за вработување и работодавач корисник согласно со Законот за приватни агенции за вработување.

Член 2

(1) Финансиската поддршка на работодавачот од членот 1 став (2) од овој закон ќе се спроведува преку Владина Програма за финансиска поддршка на работодавачи погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19 со исплата на финансиски средства на сметка на работодавачот-барател на финансиска поддршка за исплата на платите на работниците за месеците октомври, ноември и декември 2020 година (во натамошниот текст: „работодавач-барател на финансиска поддршка“).

(2) Предмет на финансиска поддршка е исплатата на платите на работниците кај работодавачот-барател на финансиска поддршка за месеците октомври, ноември и декември 2020 година, во износ најмногу до 21.776 денари месечно по работник, утврден согласно работното време (полно или неполно работно време) на кое е пријавен работникот, намалено за работното време за кое работникот остварува надоместок на плата кој не паѓа на товар на работодавачот како и согласно со членот 5 од овој закон, кој не може да биде повисок од платата на работникот која ја исплаќа работодавачот за месецот за кој бара финансиска поддршка.

(3) Бројот на вработени за кои работодавачот-барател на финансиска поддршка има право на финансиска поддршка за месеците од ставот (2) на овој член е одреден од вкупниот број на вработени во месецот за кој се бара финансиска поддршка кои се вклучени во месечната пресметка за интегрирана наплата (во натамошниот текст: МПИН образец) намален за бројот на одјавени работници за истиот месец со исклучок на одјавените работници согласно со условите од член 8 ставови (3) и (4) од овој закон.

Член 3

(1) Работодавачот-барател на финансиска поддршка поднесува Барање за финансиска поддршка за исплатата на платите на работниците до Управата за јавни приходи со Изјава за исполнетоста на условите од ставот (3) на овој член и членот 4 од овој закон. Формата и содржината на Барањето за финансиска поддршка за исплатата на платите на работниците ги пропишува министерот за финансии.

(2) Барањето од ставот (1) на овој член, работодавачот-барател на финансиска поддршка го поднесува преку системот е-даноци на Управата за јавни приходи

до 10-ти во месецот за претходниот месец, а комплетноста на Барањето го потврдува Управата за јавни приходи, во рок од три дена од денот на приемот на барањето.

(3) За користење на финансиската поддршка, работодавачот - барател на финансиска поддршка треба да ги исполни следните услови:

- месечниот просек на вкупните приходи од редовното работење остварени во периодот од април 2020 година заклучно со месец септември 2020 година, октомври 2020 година или ноември 2020 година намалени за одделни еднократни приходи кои не произлегуваат од редовното работење на работодавачот-барател на финансиска поддршка да се намалени најмалку за 30% во однос на месечниот просек на вкупните приходи остварени во периодот од месец април 2019 година заклучно со месец септември 2019 година, октомври 2019 година или ноември 2019 година, намалени за одделни еднократни приходи кои не произлегуваат од редовното работење. За обврзниците регистрирани после септември 2019, намалувањето на вкупните приходи намалени за одделни еднократни приходи кои не произлегуваат од редовното работење на работодавачот - барател на финансиска поддршка остварени во месец септември 2020 година, октомври 2020 година или ноември 2020 година да изнесува најмалку 30% во однос на месечниот просек на вкупните приходи намалени за одделни еднократни приходи кои не произлегуваат од редовното работење на работодавачот - барател на финансиска поддршка остварени од денот на запишувањето во соодветен регистар до месецот за кој се бара финансиската поддршка,

- бројот на вработени во месецот за кој се бара финансиска поддршка од овој закон да е ист или поголем со бројот на вработени заклучно со месец август 2020 година со исклучок на одјавените работници согласно со условите од членот 8 ставови (3) и (4) од овој закон и

- работодавачот-барател на финансиска поддршка да не исплатува дивиденда на сопствениците, како и да нема извршено исплата по основ на награда за деловна успешност (нема извршено исплата по основ на награда за деловна успешност на работодавачот со шифра 102 во МПИН образецот) или друг вид на годишна награда на вработените и органите на управување и надзор на работодавачот-барател на финансиска поддршка, до денот на исплата на платата за месец декември 2020 година.

(4) Работодавачот - барател на финансиска поддршка кој на повеќе од 10% од вкупниот број вработени им исплатува поединечна нето-плата повисока од 120.000 денари за месецот за кој се бара финансиска поддршка не ги исполнува условите од ставот (3) на овој член.

Член 4

(1) Работодавач-барател на финансиска поддршка не може да користи финансиска поддршка за работник доколку:

- работникот кој за месец јуни, јули, август или септември 2020 година, остварил нето-плата повисока од 39.900 денари за секој месец одделно, сразмерно на часовите на пријавено работно време (полно или неполно работно време) или доколку засновал работен однос за време пократко од четири месеци, нето платата на работникот е повисока од 39.900 денари за секој месец одделно за периодот за кој е пријавен во работен однос, сразмерно на часовите на пријавено работно време (полно или неполно работно време),

- користи ослободување од плаќање на данокот на личен доход и придонеси од задолжително социјално осигурување, согласно со Законот за вработувањето и осигурување во случај на невработеност (за мерките од проектот „Македонија вработува“) и

- вработува работник за дополнително работење, согласно со членот 121 од Законот за работните односи.

(2) Финансиска поддршка за исплата на платите не може да користи:

- орган на државна и на локална власт и други државни органи основани согласно со Уставот на Република Северна Македонија и со закон, институција која врши дејност од областа на образованието, науката, здравството, културата, трудот, социјалната заштита и заштитата на детето, спортот, како и во други дејности од јавен интерес утврден со закон, а организирани како агенции, фондови, јавни установи, јавни претпријатија и трговски друштва основани од Република Северна Македонија, општините, градот Скопје и општините во градот Скопје и

- приватна агенција за вработување за работник кој е отстапен кај работодавач од став (2) алинеја 1 на овој член.

Член 5

(1) Финансиска поддршка за исплата на плати не може да користи работодавач кој во годишната сметка и финансиските извештаи за 2017, 2018 и 2019 година има кумулативно акумулирани добивки поголеми од 600.000.000 денари.

(2) По исклучок од ставот (1) на овој член работодавачот кој има повеќе од 2.000 вработени лица во месецот за кој користи финансиска поддршка а во годишната сметка и финансиските извештаи за 2017, 2018 и 2019 година има кумулативно акумулирани добивки поголеми од 600.000.000 денари, може да користи финансиска поддршка за исплата на плата согласно со овој закон.

Член 6

(1) Износот на финансиска поддршка заради исплата на плати за октомври, ноември и декември 2020 година, се определува врз основа на процентот на намалувањето на приходот искажан во барањето од членот 3 став (1) од овој закон и тоа на следниот начин:

- за намален приход од 30% до 40% износ на финансиска поддршка до 14.500 денари,

- за намален приход од 40,01% до 50% износ на финансиска поддршка до 15.955 денари,

- за намален приход од 50,01% до 60% износ на финансиска поддршка до 17.410 денари,

- за намален приход од 60,01% до 70% износ на финансиска поддршка до 18.865 денари,

- за намален приход од 70,01% до 80% износ на финансиска поддршка до 20.320 денари,

- за намален приход од над 80% износ на финансиска поддршка до 21.776 денари.

(2) Износот на финансиска поддршка се исплатува до износот на платата која ја исплаќа работодавачот на работникот за месецот за кој бара финансиска поддршка, а најмногу до износот определен согласно со ставот (1) на овој член.

Член 7

(1) Работодавачот со комплетното барање од членот 3 став (1) од овој закон, за работниците за кои побарува финансиска поддршка, во полето 3.4б од МПИН образецот внесува шифра 5001.

(2) Работодавачот кој истовремено може да користи друга мерка за субвенционирање на социјалните придонеси и/или данок на личен доход во полето 3.23 од МПИН образецот ја внесува соодветната шифра за ослободување и истата ја комбинира (користи истовремено) со шифрата од ставот (1) од овој член.

(3) После обработката на МПИН образецот, Управата за јавни приходи го информира работодавачот-барател на финансиска поддршка за вкупниот износ на финансиската поддршка што ќе биде исплатена за соодветниот месец.

(4) Управата за јавни приходи ја известува Владата на Република Северна Македонија за работодавачите кои ги исполниле условите за финансиска поддршка за исплата на платите. Известувањето содржи податоци за: ЕДБ/ЕМБГ на работодавачот-даночен обврзник, назив/име и презиме, адресни податоци, износ на одобрената финансиска поддршка и трансакциска сметка на работодавачот-корисник на финансиска поддршка.

(5) Износот на финансиска поддршка од членот 2 став (1) од овој закон се исплатува до 15-ти во месецот за претходниот месец преку Владина Програма за финансиска поддршка на работодавачи погодени од здравствено-економската криза предизвикана од вирусот COVID-19 на сметка на работодавачот-барател на финансиска поддршка кој ги исполнил условите од членот 3 став (3) и членот 4 од овој закон, согласно со известувањето од Управата за јавни приходи.

(6) Роковите за поднесување на МПИН образецот до Управата за јавни приходи и исплатата на платата, данокот на личен доход и придонесите од задолжително социјално осигурување се уредени со Законот за работните односи, Законот за данокот на личен доход и Законот за придонеси од задолжително социјално осигурување.

Член 8

(1) Работодавачот кој користел финансиска поддршка за исплата на плати за вработениот за кој примил финансиска поддршка, должен е да му ја исплати платата најмалку до износот на примената финансиска поддршка но не помалку од износот на минималната плата утврдена со Законот за минимална плата на Република Северна Македонија.

(2) Работодавачот кој користел финансиска поддршка за исплата на плати има обврска да ги врати добиените финансиски средства во целост, заедно со камата утврдена согласно со Законот за даночна постапка, доколку по извршената контрола од страна на Управата за јавни приходи и/или Државниот инспекторат за труд се утврди дека работодавачот не ги исполнил условите од ставот (3) на овој член и од членот 3 став (3), членот 4 и членот 5 став (1) од овој закон.

(3) За времетраење на финансиската поддршка согласно со овој закон и два месеци после завршувањето на месецот за кој е користена финансиската поддршка, бројот на вработени кај работодавачот кој користи финансиска поддршка за исплата на плати, во однос на бројот на вработени во месецот за кој користел финансиска поддршка, не смее да се намалува, освен заради:

- пензионирање и смрт на работник,
- откажување на договорот за вработување од страна на работникот,
- откажување на договорот за вработување без отказен рок од страна на работодавачот поради кршење на работниот ред и дисциплина или работните обврски,
- спогодбено преземање на работник,
- престанување на важноста на договорот за вработување врз основа на судска пресуда и
- престанување на важноста на договорот за вработување поради утврдена трајна неспособност за работа.

(4) Согласно со ставот (3) на овој член, два месеци после завршувањето на месецот за кој е користена финансиската поддршка вкупниот број на вработени кај работодавачот - корисник на финансиска поддршка не смее да се намали за повеќе од:

- 15% кај работодавач кој имал до 50 вработени во месецот за кој користел финансиска поддршка,
- 10% кај работодавач кој имал од 51 до 250 вработени во месецот за кој користел финансиска поддршка и
- 5% кај работодавач кој имал над 250 вработени во месецот за кој користел финансиска поддршка.

Член 9

(1) Работодавачот кој го искористил правото на финансиска поддршка за исплата на плата согласно со овој закон има обврска примените финансиски средства да ги врати во Буџетот на Република Северна Македонија, но најмногу до износот од 50% од остварениот финансиски резултат пред оданочување за 2020 година зголемен за износот на оданочивите расходи и помалку искажаните приходи во Даночниот биланс за обврзниците на данокот на добивка; за обврзниците на годишниот данок на вкупен приход, најмногу до износот од 50% од финансискиот резултат пред оданочување искажан во Билансот на успех, односно за вршителите на дејност, најмногу до износот од 50% од износот на искажаниот финансиски резултат пред оданочување во Билансот на приходи и расходи (образец Б) за 2020 година, зголемен за непризнаените расходи за даночни цели во годишниот Даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност за што поднесува Барање за пресметување на износот за враќање на примената финансиска поддршка за исплата на плати до Управата за јавни приходи, најдоцна до рокот за поднесување на даночниот биланс за 2020 година.

(2) Формата и содржината на Барањето за пресметување на износот на враќање на примената финансиска поддршка за исплата на плати од ставот (1) на овој член ги пропишува министерот за финансии.

(3) Враќањето на износот од ставот (1) на овој член ќе се изврши на три месечни рати, без камата, во месеците октомври, ноември и декември 2021 година.

(4) Работодавачот кој го искористил правото на финансиска поддршка за исплата на плати согласно со овој закон и кој не искажал даночна основа за оданочување во даночниот биланс за оданочување на добивка „образец“ ДБ, односно искажал негативен финансиски резултат (загуба пред оданочување) во Билансот на успех, за обврзниците на годишниот данок на вкупен приход кои доставуваат Даночен биланс на вкупен приход „образец ДБ-ВП“, односно не искажал даночна основа во Годишниот Даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност „образец ДЛД-ДБ износот на примена финансиска поддршка за исплата на плати нема да ја врати во Буџетот на Република Северна Македонија, доколку нема обврски по основ на неплатени даноци и придонеси.

Член 10

За работодавачот - корисник на финансиска поддршка кој дал Изјава согласно со членот 3 став (1) од овој закон, а не ги исполнил условите од членот 3 став (3) и членот 4 од овој закон, ќе се применуваат одредбите од Кривичниот законик.

Член 11

(1) Глоба во износ од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за сторен прекршок на микро правно лице, од 500 до 2.000 евра во денарска противвредност на мало правно лице, од 1.000 до 6.000 евра во денарска противвредност за средно правно лице и од 1.000 до 10.000 евра во денарска противвредност на големо правно лице:

- ако правното лице постапува спротивно на членот 8 став (1) од овој закон односно за вработениот за кој примил финансиска поддршка, исплатил пониска плата од износот на примената финансиска поддршка,
- ако правното лице постапува спротивно на членот 8 став (2) од овој закон, односно не ја исполни обврската за враќање на добиените финансиски средства во целост, заедно со камата за јавни давачки, по извршена контрола од страна на Управата за јавни приходи и/или Државниот инспекторат за труд поради неисполнетост на условите од членот 3 став (3), членот 4 и членот 5 став (1) од овој закон.

(2) Глоба во износ од 100 до 250 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за сторен прекршок на физичкото лице:

- ако физичкото лице постапува спротивно на членот 8 став (1) од овој закон односно за вработениот за кој примил финансиска поддршка, исплатил пониска плата од износот на примената финансиска поддршка,
- ако физичкото лице постапува спротивно на членот 8 став (2) од овој закон, односно не ја исполни обврската за враќање на добиените финансиски средства во целост, заедно со камата за јавни давачки, по извршена контрола од страна на Управата за јавни приходи и/или Државниот инспекторат за труд поради неисполнетост на условите од членот 3 став (3), членот 4 и членот 5 став (1) од овој закон.

(3) Глоба во износ од 100 до 500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за сторен прекршок на одговорното лице во правното лице од ставот (1) на овој член, ако:

- постапува спротивно на членот 8 став (1) од овој закон односно за вработениот за кој примил финансиска поддршка, исплатил пониска плата од износот на примената финансиска поддршка,
- постапува спротивно на членот 8 став (2) од овој закон, односно не ја исполни обврската за враќање на добиените финансиски средства во целост, заедно со камата за јавни давачки, по извршена контрола од страна на Управата за јавни приходи и/или Државниот инспекторат за труд поради неисполнетост на условите од членот 3 став (3), членот 4 став (2) и членот 5 став (1) од овој закон.

(4) Прекршочна постапка води и прекршочна санкција изрекува надлежен суд.

Член 12

(1) Работодавачите кои го искористиле правото на финансиска поддршка за исплата на плати, а кои согласно со Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците април, мај и јуни 2020 година („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 111/20, 113/20 и 154/20), имаат обврска да ги вратат примените финансиски средства во Буџетот на Република Северна Македонија поднесуваат Барање за пресметување на износот за враќање на примената финансиска поддршка за исплата на плати до Управата за јавни приходи, најдоцна до рокот за поднесување на даночниот биланс за 2020 година.

(2) Формата и содржината на Барањето за пресметување на износот на враќање на примената финансиска поддршка за исплата на плати од ставот (1) на овој член ја пропишува министерот за финансии.

(3) Работодавачите кои го искористиле правото на финансиска поддршка за исплата на плати, а кои согласно со Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците април, мај и јуни 2020 година („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 111/20, 113/20 и 154/20), ги исполниле условите за претворање на финансиската поддршка за исплата на плати во грант, најдоцна до рокот за поднесување на Даночниот биланс за 2020 година, доставуваат Барање за претворање на финансиската поддршка за исплата на плати во грант до Управата за јавни приходи.

(4) Формата и содржината на Барањето за претворање на финансиската поддршка за исплата на плати во грант од ставот (3) на овој член ги пропишува министерот за финансии.

Член 13

Работодавачот корисник на финансиската помош согласно со овој закон доколку бил корисник на финансиска поддршка и согласно со Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците април, мај и јуни 2020 година („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 111/20, 113/20 и 154/20), износот на финансиска поддршка за исплата на плата кој има обврска согласно со членот 9 од овој закон и согласно со Уредбата со законска сила за финансиска поддршка на работодавачите погодени од здравствено-економска криза предизвикана од Коронавирусот COVID-19, заради исплата на платите за месеците април, мај и јуни 2020 година („Службен весник на Република Северна Македонија“ број 111/20, 113/20 и 154/20), да го врати во Буџетот на Република Северна Македонија не може кумулативно да го надмине износот од 50% од остварениот финансиски резултат пред оданочување за 2020 година зголемен за износот на оданочивите расходи и помалку искажаните приходи во Даночниот биланс за обврзниците на данокот на добивка; за обврзниците на годишниот данок на вкупен приход, не може да го надмине износот од 50% од финансискиот резултат пред оданочување искажан во Билансот на успех, односно за вршителите на дејност, не може да го надмине износот од 50% од износот на искажаниот финансиски резултат пред оданочување во Билансот на приходи и расходи (образец Б) за 2020 година, зголемен за непризнаените расходи за даночни цели во годишниот Даночен биланс за утврдување на данокот на доход од вршење на самостојна дејност.

Член 14

Подзаконските акти утврдени во овој закон ќе се донесат во рок од десет дена од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 15

Овој закон влегува во сила со денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

**L I G J**
**I MBËSHTETJES FINANCIARE TË PUNËDHËNËSVE TË PREKUR NGA KRIZA SHËNDETËSORE EKONOMIKE, E SHKAKTUAR NGA VIRUSI COVID-19, PËR SHKAK TË PAGESËS SË RROGAVE PËR MUAJT TETOR, NËNTOR DHE DHJETOR 2020**

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe procedura për marrjen e mbështetjes financiare të punëdhënësve të prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi COVID-19, për shkak të pagesës së rrogave të punëtorëve për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020.

(2) "Punëdhënës" në kuptim të këtij ligji është çdo person juridik që punëson punëtorë në bazë të një kontrate pune, person fizik që punëson punëtorë në bazë të një kontrate pune dhe një punëdhënës shfrytëzues në pajtim me Ligjin e Agjencive Private të Punësimit.

Neni 2

(1) Mbështetja financiare e punëdhënësit nga neni 1 paragrafi (2) të këtij ligji do të zbatohet nëpërmjet Programit qeveritar për mbështetje financiare të punëdhënësve të prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi COVID-19, me pagimin e mjeteve financiare në llogarinë e punëdhënësit – kërkues i mbështetjes financiare për pagesë të rrogave të punëtorëve për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020 (në tekstin e mëtejmë: "punëdhënës-kërkues i mbështetjes financiare").

(2) Subjekt i mbështetjes financiare është pagesa e rrogave të punëtorëve te punëdhënësi-kërkues i mbështetjes financiare për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, deri në shumë prej 21,776 denarë në muaj për të punësuar, të përcaktuar sipas orarit të punës (orar i plotë ose i paplotë) në të cilin është paraqitur punëtori, e zvogëluar për orët e punës për të cilat punëtori realizon kompensim rroge që nuk bie në barrë të punëdhënësit, si dhe në pajtim me nenin 5 të këtij ligji, i cili nuk mund të jetë më i lartë se rroga e punëtorit e paguar nga punëdhënësi për muajin për të cilin kërkon mbështetje financiare.

(3) Numri i të punësuarve për të cilët punëdhënësi - kërkues i mbështetjes financiare ka të drejtë të mbështetjes financiare, për muajt sipas paragrafit (2) të këtij neni, është i caktuar nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në muajin në të cilin kërkohet mbështetje financiare, e të cilët janë të përfshirë në llogaritë mujore për arkëtim të integruar (në teksin e mëtejmë: formulari LLMAI) i zvogëluar për numrin e punëtorëve të çregjistruar për muajin e njëjtë, me përjashtim të punëtorëve të çregjistruar sipas kushteve të nenit 8 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji.

Neni 3

(1) Punëdhënësi-kërkues i mbështetjes financiare parashtron Kërkesë për mbështetje financiare të pagesës së rrogave të punëtorëve në Drejtorinë e të Hyrave Publike, me Deklaratë për përmbushjen e kushteve, sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe nenit 4 të këtij ligji. Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e Kërkesës për mbështetje financiare të pagesës së rrogave të punëtorëve.

(2) Kërkesën. sipas paragrafit (1) të këtij neni, punëdhënësi-kërkues i mbështetjes financiare e parashtron nëpërmjet sistemit të e-tatimeve të Drejtorisë së të Hyrave Publike, deri më datë 10 të muajit. për muajin paraprak, ndërkaq kompletimin e Kërkesës e vërteton Drejtoria e të Hyrave Publike, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Për shfrytëzimin e mbështetjes financiare, punëdhënësi - kërkues i mbështetjes financiare duhet t'i përmbushë këto kushte:

- mesatarja mujore e të ardhurave të përgjithshme nga puna e rregullt, të realizuara në perudhën nga prilli 2020 përmbyllur me muajin shtator 2020, tetor 2020, ose nëntor 2020, të zvogëluara për të ardhura të njëhershme të veçanta që nuk dalin nga puna e rregullt e punëdhënësit-kërkues i mbështetjes financiare, të jenë zvogëluar së paku 30%, në raport me mesataren mujore të të ardhurave të përgjithshme të realizuara në periudhën nga muaji prill 2019 përmbllur me muajin shtator 2019, tetor 2019 ose nëntor 2019, të zvogëluara për të ardhura të njëhershme të veçanta që nuk dalin nga puna e rregullt. Për të detyruarit e regjistruar pas shtatorit 2019, zvogëlimi i të ardhurave të përgjithshme të zvogëluara për të ardhura të njëhershme të veçanta që nuk dalin nga puna e rregullt e punëdhënësit-kërkues i përkrahjes financiare të realizuara në muajin shtator 2020, tetor 2020 ose nëntor 2020 të jetë së paku 30% në raport me mesataren mujore të të ardhurave të përgjithshme të zvogëluara për të ardhura të njëhershme të veçanta që nuk dalin nga puna e rregullt e punëdhënësit i kërkues i mbështetjes financiare të realizuara nga dita e regjistrimit në regjistrin përkatës deri në muajin që i paraprin muajit për të cilin kërkohet mbështetje financiare,
- numri i të punësuarve në muajin për të cilin kërkohet përkrahja financiare nga ky ligj të jetë i njëjtë ose më i madh me numrin e të punësuarve përmbyllur me muajin gusht 2020 me përjashtim të punëtorëve të çregjistruar sipas kushteve të nenit 8 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji dhe
- punëdhënësi - kërkues i mbështetjes financiare të mos paguajë devidendë të pronarëve, si dhe të mos ketë kryer pagesë në bazë të shpërblimit për sukses afarist (nuk ka kryer pagesë në bazë të shpërblimit për sukses afarist të punëdhënësit me shifra 102 në formularin LLMAI) ose lloj tjetër të shpërblimit vjetor të të punësuarve dhe të organeve të menaxhimit dhe të mbikëqyrjes së punëdhënësit - kërkues i mbështetjes financiare, deri në ditën e pagesës së rrogës për muajin dhjetor 2020.

(4) Punëdhënësi - kërkues i mbështetjes financiare i cili, në më shumë se 10% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, u paguan rrogë individuale neto më të lartë se 120.000 denarë për muajin për të cilin kërkohet mbështetje financiare, nuk i përmbush kushtet sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Neni 4

(1) Punëdhënësi-kërkues i mbështetjes financiare nuk mund të shfrytëzojë përkrahje financiare për punëtor nëse:

- punëtori i cili për muajin qershor, korrik, gusht ose shtator 2020 ka realizuar rrogë neto më të lartë se 39.900 denarë për çdo muaj veç e veç, në përpjestim me orët e orarit të paraqitur të punës (orar të plotë ose të paplotë të punës) ose nëse ka themeluar marrëdhënie pune më të shkurtë se katër muaj, rroga neto e punëtorit është më e lartë se 39.900 denarë për çdo muaj veç e veç për periudhën për të cilën është paraqitur në marrëdhënien e punës, në përpjestim me orët e orarit të paraqitur të punës (orar i plotë ose i paplotë i punës),
- shfrytëzon lirim nga pagesa e tatimit mbi të ardhura personale dhe kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social, në pajtim me Ligjin e Punësimit dhe të Sigurimit në rast të Papunësisë (për masat nga projekti "Maqedonia Punëson") dhe
- punëson punëtor për punë plotësuese, në pajtim me nenin 121 të Ligjit të Marrëdhënieve të Punës.

- (2) Mbështetje financiare për pagesën e rrogave nuk mund të shfrytëzojë:

- organi i pushtetit shtetëror dhe atij lokal dhe organet tjera shtetërore të themeluara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe me ligj, institucioni i cili kryen veprimtari nga sfera e arsimit, shkencës, shëndetësisë, kulturës, e punës, mbrojtjes sociale, me interes publik të përcaktuar me ligj, ndërkaq të organizuara si agjenci, fonde, institucione publike, ndërmarrje publike dhe shoqëri tregtare të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut, komunat, qyteti i Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit dhe

- agjenci private punësimi për punëtor i cili është i përfaqësuar te punëdhënësi i paragrafit (2) nënparagrafit 1 të këtij neni.

Neni 5

(1) Mbështetje financiare për pagesën e rrogave nuk mund të shfrytëzojë punëdhënësi i cili, në llogarinë vjetore dhe raportet financiare për vitin 2017, 2018 dhe 2019, ka përfitime të grumbulluara kumulative më të mëdha se 600.000.000 denarë.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, punëdhënësi i cili ka më shumë se 2.000 persona të punësuar në muajin për të cilin shfrytëzon mbështetje financiare, ndërkaq në llogarinë vjetore dhe raportet financiare për vitin 2017, 2018 dhe 2019 ka përfitime të grumbulluara kumulative më të madh se 600.000.000 denarë, mund të shfrytëzojë mbështetje financiare për pagesën e rrogës në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

(1) Shuma e mbështetjes financiare për shkak të pagesës së rrogave për tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, përcaktohet në bazë të përqindjes së zvogëluar të të ardhurave, të paraqitur në kërkesën sipas nenit 3 paragrafi (1) të këtij ligji, sipas mënyrës që vijon:

- për të ardhura të zvogëluara prej 30% deri 40%, shumë e mbështetjes financiare deri 14.500 denarë

- për të ardhura të zvogëluara prej 40,01% deri 50%, shumë e mbështetjes financiare deri 15.955 denarë

- për të ardhura të zvogëluara prej 50,01% deri 60%, shumë e mbështetjes financiare deri 17.410 denarë

- për të ardhura të zvogëluara prej 60,01% deri 70%, shumë e mbështetjes financiare deri 18.865 denarë

- për të ardhura të zvogëluara prej 70,01% deri 80% shumë e mbështetjes financiare deri 20.320 denarë

- për të ardhura të zvogëluar prej 80%, shumë e mbështetjes financiare deri 21.776 denarë.

(2) Shuma e mbështetjes financiare paguhet deri në shumën e rrogës që e paguan punëdhënësi i punëtorit për muajin për të cilin kërkon përkrahje financiare, ndërkaq më së shumti deri në shumën e caktuar sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 7

(1) Punëdhënësi, me kërkesën e plotë sipas nenit 3 paragrafi (1) të këtij ligji, për punëtorët për të cilët kërkon përkrahje financiare, në fushën 3.4b të formularit LLMAI e shënon shifrën 5001.

(2) Punëdhënësi i cili njëkohësisht mund të shfrytëzojë masë tjetër për subvencionimin e kontributeve sociale dhe/ose tatimin e të ardhurave personale, në fushën 3.23 të formularit LLMAI e shënon shifrën e duhur për lirimin dhe këtë e kombinon (shfrytëzon njëkohësisht) me shifrën sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Pas përpunimit të formularit LLMAI, Drejtoria e të Hyrave Publike e informon punëdhënësin-kërkues të mbështetjes financiare për shumën e përgjithshme të mbështetjes financiare që do të paguhet për muajin adekuat.

(4) Drejtoria e të Hyrave Publike e njofton Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për punëdhënësit të cilët i kanë përmbushur kushtet për mbështetje financiare për pagesën e rrogave. Njoftimi përmban të dhëna për: NUT/NUAQ të punëdhënësit - tatimpagues, titullin/emrin dhe mbiemrin, adresën, shumën e lejuar të mbështetjes financiare dhe llogarinë bankare të punëdhënësit - shfrytëzues i mbështetjes financiare.

(5) Shuma e mbështetjes financiare, sipas nenit 2 paragrafi (1) të këtij ligji, paguhet deri më datë 15-të të muajit, për muajin paraprak nëpërmjet Programit qeveritar për mbështetje financiare të punëdhënësve të prekur nga kriza ekonomike shëndetësore, e shkaktuar nga virusi COVID-19, në llogari të punëdhënësit - kërkues i mbështetjes financiare i cili i ka plotësuar kushtet sipsa nenit 3, paragrafi (3) dhe nenit (4) të këtij ligji, në pajtim me njoftimin e Drejtorisë së të Hyrave Publike.

(6) Afatet për parashtrimin e formularit LLMAI te Drejtoria e të Hyrave Publike dhe pagesën e rrogave, tatimin mbi të ardhura personale dhe kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social janë rregulluara me Ligjin për marrëdhënie pune, Ligjin për tatim mbi të ardhurat personale dhe Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social.

Neni 8

(1) Punëdhënësi i cili ka shfrytëzuar mbështetje financiare për pegesën e rrogave për të punësuarin për të cilin ka pranuar mbështetje financiare, është i detyruar t'i paguaj rrogë së paku deri në shumën e zbatimit të mbështetjes financiare, por jo më pak se shuma e rrogës minimale e përcaktuar me Ligjin e Rrogës Minimale të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Punëdhënësi i cili ka shfrytëzuar mbështetje financiare për pagesën e rrogave, ka për detyrë që t'i kthejë mjetet e marra financiare në tërësi, së bashku me kamatën e përcaktuar në pajtim me Ligjin e Procedurës Tatimore, nëse pas kontrollit të realizuar nga Drejtoria e të Hyrave Publike dhe/ose Inspektorati Shtetëror i Punës përcaktohet se punëdhënësi nuk i ka plotësuar kushtet sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe nenit 3 paragrafi (3), nenit 4 dhe nenit 5 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Për kohëzgjatjen e mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj dhe dy muaj pas përfundimit të muajit për të cilin është shfrytëzuar mbështetja financiare, numri i të punësuarve te punëdhënësi i cili shfrytëzon mbështetje financiare për pagesën e rrogave, në raport me numrin e të punësuarve në muajin për të cilin ka shfrytëzuar përkrahje financiare, nuk guxon të zvogëlohet, përveç arsyes së:

- pensionimit dhe vdekjes së punëtorit,

- zgjidhjes së kontratës së punësimit nga ana e punëtorit,

- zgjidhjes së kontratës së punësimit pa afat të dorëheqjes nga ana e punëdhënësit për shkak të shkeljes së rendit të punës dhe disiplinës ose detyrimeve të punës,

- transferit me marrëveshje të punëtorit,

- përfundim të kontratës së punësimit në bazë të aktgjykimeve gjyqësore dhe

- përfundim të kontratës së punësimit për shkak përcaktimit të paaftësisë së përhershme për punë.

(4) Në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, dy muaj pas mbarimit të muajit për të cilin është shfrytëzuar mbështetja financiare numri i përgjithshëm i të punësuarve te punëdhënësi - shfrytëzues i mbështetjes financiare nuk guxon të zvogëlohet për më shumë se:

- 15% te punëdhënësi i cili ka pasur deri në 50 të punësuar në muajin për të cilin ka shfrytëzuar mbështetje financiare,

-10% te punëdhënësi i cili ka pasur prej 51 deri 250 të punësuar në muajin për të cilin ka shfrytëzuar mbështetje financiare dhe

-5% te punëdhënësi i cili ka pasur mbi 250 të punësuar në muajin për të cilin ka shfrytëzuar mbështetje financiare.

Neni 9

Punëdhënësi i cili e ka shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare për pagesën e rrogës në pajtim me këtë ligj ka për detyrë që mjetet e pranuara financiare t'i kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, por më së shumti deri në shumë prej 50% nga rezultati financiar i realizuar para tatimimit për vitin 2020 të rritur për shumën e shpenzimeve të tatimuara dhe të hyrat më pak të shprehura në Bilancin tatimor për tatimpaguesit e tatimit mbi fitim; për tatimpaguesit e tatimit vjetor të të hyrave të përgjithshme, më së shumti deri në shumë prej 50% të rezultatit financiar para tatimimit të shprehur në Bilancin e suksesit, përkatësisht për ushtruesit e detyrës, më së shumti deri në shumë prej 50% të shumës së rezultatit financiar të shprehur para tatimimit në Bilancin e të hyrave dhe të shpenzimeve (formulari B) për vitin 2020, të rritur për shpenzimet e papranuara për qëllime tatimore në Bilancin tatimor vjetor për përcaktimin e tatimit mbi fitim nga kryerja e veprimtarisë së pavarur për çka parashtron Kërkesë për përllogaritjen e shumës për kthimin e mbështetjes së pranuar financiare për pagesën e rrogave në Drejtorinë e të Hyrave Publike, më së voni deri në afatin për parashtrimin e bilancit tatimor për vitin 2020.

(2) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e Kërkesës për përllogaritjen e shumës së kthimit të mbështetjes së pranuar financiare për pagesa të rrogave, sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Kthimi i shumës së paragrafit (1) të këtij neni do të bëhet në këste mujore, pa kamatë, në muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2021.

(4) Punëdhënësi i cili e ka shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare për pagesën e rrogave në pajtim me këtë ligj dhe i cili nuk ka shprehur bazë tatimore për tatimim në bilancin tatimor për tatimim të fitimit "formular" BT, përkatësisht ka shprehur rezultat financiar negativ (humbje para tatimimit) në Bilancin e suksesit, për obliguesit e tatimit vjetor të të hyrave të përgjithshme të cilët dorëzojnë Bilanc tatimor të të hyrave të përgjithshme "formular BT-HP", përkatësisht nuk ka shprehur bazë tatimore në Bilancin tatimor vjetor për përcaktimin e tatimit mbi fitim nga kryerja e veprimtarisë së pavarur "formular TFP-BT, shumën e mbështetjes së pranuar financiare për pagesë të rrogave nuk do ta kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nëse nuk ka detyrime në bazë të tatimeve dhe kontributeve të papaguara.

Neni 10

Për punëdhënësin – shfrytëzues të mbështetjes financiare i cili ka dhënë Deklaratë në pajtim me nenin 3 paragrafin (1) të këtij ligji, ndërkaq nuk i ka plotësuar kushtet sipas nenit 3 paragrafi (3) dhe nenit 4 të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e Kodit penal.

Neni 11

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik mikro, për kundërvajtjen e kryer, prej 500 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari personit juridik të vogël, prej 1.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari për person juridik të mesëm dhe prej 1.000 deri 10.000 euro në kundërvlerë denari personit juridik të madh:

- nëse personi juridik vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (1) të këtij ligji përkatësisht për të punësuarin për të cilin ka pranuar mbështetje financiare, ka paguar rrogë më të ulët nga shuma e mbështetjes së pranuar financiare.

- nëse personi juridik vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (2) të këtij ligji, përkatësisht nuk e plotëson detyrimin për kthimin e mjeteve të fituara financiare në tërësi, së bashku me kamatën për të dhëna publike, pas kontrollit të kryer nga Drejtoria e të Hyrave Publike dhe/ose Inspektorati Shtetëror i Punës për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas nenit 3 paragrafi (3), nenit 4 dhe nenit 5 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit fizik, për kundërvajtje:

- nëse personi fizik vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (1) të këtij ligji përkatësisht për të punësuarin për të cilin ka pranuar mbështetje financiare, ka paguar rrogë më të ulët nga shuma e mbështetjes së pranuar financiare.

- nëse personi fizik vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (2) të këtij ligji, përkatësisht nuk e plotëson detyrimin për kthimin e mjeteve të fituara financiare në tërësi, së bashku me kamatën për të dhëna publike, pas kontrollit të kryer nga Drejtoria e të Hyrave Publike dhe/ose Inspektorati Shtetëror i Punës për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas nenit 3 paragrafi (3), nenit 4 dhe nenit 5 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Gjobë në shumë prej 100 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet përgjegjës në personin juridik për kundërvajtje sipsa paragrafit (1) të këtij neni nëse:

- vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (1) të këtij ligji përkatësisht për të punësuarin për të cilin ka pranuar mbështetje financiare, ka paguar rrogë më të ulët nga shuma e mbështetjes së pranuar financiare.

- vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafin (2) të këtij ligji, përkatësisht nuk e plotëson detyrimin për kthimin e mjeteve të fituara financiare në tërësi, së bashku me kamatën për të dhëna publike, pas kontrollit të kryer nga Drejtoria e të Hyrave Publike dhe/ose Inspektorati Shtetëror i Punës për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas nenit 3 paragrafi (3), nenit 4 paragrafi (2) dhe nenit 5 paragrafi (1) të këtij ligji.

(4) Procedurë kundërvajtëse drejton dhe sanksion kundërvajtës shqipton gjykata kompetente.

Neni 12

Punëdhënësit të cilët e kanë shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare për pagesën e rrogës, ndërkaq të cilët në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësit të prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi korona Covid-19, për shkak të pagesës së rrogave për muajt prill, maj dhe qershor 2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 111/20, 113/20 dhe 154/20) kanë për detyrë t'i kthejnë mjetet e pranuara financiare në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, parashtrojnë Kërkesë për përllogaritjen e shumës për kthimin e mbështetjes së pranuar financiare për pagesë të rrogave në Drejtorinë e të Hyrave Publike, më së voni deri në afatin për parashtrimin e bilancit tatimor për vitin 2020.

(2) Ministri i Financave e përcakton formën dhe përmbajtjen e Kërkesës për përllogaritjen e shumës së kthimit të mbështetjes së pranuar financiare për pagesa të rrogave sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Punëdhënësit të cilët e kanë shfrytëzuar të drejtën e mbështetjes financiare për pagesë të rrogave, ndërkaq të cilët në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësit të prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi korona Covid-19, për shkak të pagesës së rrogave për muajt prill, maj dhe qershor 2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 111/20, 113/20 dhe 154/20) i kanë plotësuar kushtet për shndërrimin e mbështetjes financiare për pagesë të rrogave në grant, më së voni deri në afatin për parashtrimin e Bilancit tatimor për vitin 2020, dorëzojnë Kërkesë për shndërrimin e mbështetjes financiare për pagesë të rrogave në grant në Drejtorinë e të Hyrave Publike.

(4) Ministri e financave e përckaton formën dhe përmbajtjen e Kërkesës për shndërrimin e mbështetjes financiare për pagesë të rrogave në grant sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Neni 13

Punëdhënësi shfrytëzues i mbështetjes financiare në pajtim me këtë ligj, nëse ka qenë shfrytëzues i mbështetjes financiare në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për mbështetje financiare të punëdhënësit t prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi korona Covid-19, për shkak të pagesës së rrogave për muajt prill, maj dhe qershor 2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 111/20, 113/20 dhe 154/20) shumën e mbështetjes financiare për pagesë të rrogës i cili ka për detyrim që në pajtim me nenin 9 të këtij ligji dhe në pajtim me Dekretin me fuqi të ligjit për mbështetje financiare të punëdhënësit të prekur nga kriza shëndetësore ekonomike, e shkaktuar nga virusi Covid-19, për shkak të pagesës së rrogave për muajt prill, maj dhe qershor 2020 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 111/20, 113/20 dhe 154/20) ta kthejë në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mundet që në mënyrë kumulative ta tejkalojë shumën prej 50% nga rezultati i realizuar financiar para tatimimit për vitin 2020 të rritur për shumën e shpenzimeve tatimore dhe të hyrat më pak të shprehura në Bilancin tatimor për obliguesit e tatimit mbi fitim; për tatimpaguesit e tatimit vjetor të të hyrave të përgjithshme, nuk mund ta tejkalojë shumën prej 50% nga rezultati financiar para tatimimit të shprehur në Bilancin e suksesit, përkatësisht për kryerësit e veprimtaris, nuk mund ta tejkalojë shumën prej 50% të shumës së rezultatit të shprehur financiar para tatimimit në Bilancin e të hyrave dhe shpenzimeve (formular B) për vitin 2020, të rritur për shpenzimet e papranuara për qëllime tatimore në Bilancin Tatimor vjetor për përcaktimin e tatimit mbi fitim nga kryerja e veprimtarisë së pavarur.

Neni 14

Aktet nënligjore të përcaktuara në këtë ligj do të miratohen në afat prej dhjetë ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 15

Ky ligj hyn në fuqi ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

## МИНИСТЕРСТВО ЗА ФИНАНСИИ

**3517.**

Врз основа на член 55 став (1) од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија" бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија" бр.96/19 и 110/19) министерот за финансии донесе

### ПРАВИЛНИК
### ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕТО НА ПРАВИЛНИКОТ ЗА ПРОВЕРКА НА СПОСОБНОСТИТЕ И ОЦЕНКА НА ЛИЧНИТЕ ПРЕДИСПОЗИЦИИ НА ЛИЦАТА ЗА ВРШЕЊЕ НА РАБОТИТЕ НА ФИНАНСИСКАТА ПОЛИЦИЈА

Член 1

Со овој правилник престанува да важи Правилникот за проверка на способностите и оценка на личните предиспозиции на лицата за вршење на работите на финансиската полиција („Службен весник на Република Македонија" бр.31/04).

Член 2

Овој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија".

Бр. 19-7272/1
2 ноември 2020 година
Скопје

Министер за финансии,
d-r **Fatmir Besimi,** с.р.

**3518.**

Врз основа на член 55 став (1) од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија" бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија" бр.96/19 и 110/19) министерот за финансии донесе

### ПРАВИЛНИК
### ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕТО НА ПРАВИЛНИКОТ ЗА КРИТЕРИУМИТЕ НА ПРИБИРАЊЕ НА ИНФОРМАЦИИ И ПОДАТОЦИ И КРИТЕРИУМИТЕ НА ПОСРЕДНИТЕ МЕТОДИ ЗА ДОКАЖУВАЊЕ НА ПРИХОДИТЕ

Член 1

Со овој правилник престанува да важи Правилникот за критериумите на прибирање на информации и податоци и критериумите на посредните методи за докажување на приходите („Службен весник на Република Македонија" бр.13/04).

Член 2

Овој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија".

Бр. 19-7273/1
2 ноември 2020 година
Скопје

Министер за финансии,
d-r **Fatmir Besimi,** с.р.

**3519.**

Врз основа на член 55 став (1) од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија" бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија" бр.96/19 и 110/19) министерот за финансии донесе

### ПРАВИЛНИК
### ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕТО НА ПРАВИЛНИКОТ ЗА МЕРКИТЕ ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА ДЕЛОВНИ ПРОСТОРИИ РЕГИСТРИРАНИ ЗА ВРШЕЊЕ НА ДЕЈНОСТ, МАГАЦИНИ И ДРУГИ ОБЈЕКТИ ЗА СКЛАДИРАЊЕ НА СТОКА, ПРЕДМЕТИ И ДОКУМЕНТАЦИЈА ЗА ДЕЛОВНО РАБОТЕЊЕ

Член 1

Со овој правилник престанува да важи Правилникот за мерките за обезбедување на деловни простории регистрирани за вршење на дејност, магацини и други

објекти за складирање на стока, предмети и документација за деловно работење („Службен весник на Република Македонија“ бр.69/09).

Член 2

Овој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

Бр. 19-7274/1
2 ноември 2020 година
Скопје

Министер за финансии,
d-r **Fatmir Besimi,** с.р.

**3520.**

Врз основа на член 55 став (1) од Законот за организација и работа на органите на државната управа („Службен весник на Република Македонија“ бр.58/00, 44/02, 82/08, 167/10, 51/11 и „Службен весник на Република Северна Македонија“ бр.96/19 и 110/19) министерот за финансии донесе

**П Р А В И Л Н И К**
**ЗА ПРЕСТАНУВАЊЕ НА ВАЖЕЊЕТО НА ПРАВИЛНИКОТ ЗА СЛУЖБЕНАТА УНИФОРМА НА ФИНАНСИСКАТА ПОЛИЦИЈА**

Член 1

Со овој правилник престанува да важи Правилникот за службената униформа на финансиската полиција („Службен весник на Република Македонија“ бр. 31/04).

Член 2

Овој правилник влегува во сила наредниот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија“.

Бр. 19-7275/1
2 ноември 2020 година
Скопје

Министер за финансии,
d-r **Fatmir Besimi,** с.р.

СЛУЖБЕН ВЕСНИК
на Република Северна Македонија

**www.slvesnik.com.mk** **contact@slvesnik.com.mk**

**Издавач: ЈП СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА, ц.о. – Скопје**
**бул. „Партизански одреди“ бр. 29. Поштенски фах 51.**
**в. д. директор и одговорен уредник – Татијана Лалчевска**
**телефон: +389-2-55 12 400**
**телефакс: +389-2-55 12 401**

**Претплатата за 2020 година изнесува 12.200,00 денари.**
**„Службен весник на Република Северна Македонија“ излегува по потреба.**
**Рок за рекламации: 15 дена.**
**Жиро-сметка: 300000000188798.**
**Депонент на Комерцијална банка, АД – Скопје.**
**Печат: Печатница НАПРЕДОК ДООЕЛ Тетово.**

ISSN 0354-1622
2020267